



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2023

VENDIM

Nr. 432, datë 18.07.2023

PËR

VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT {...}, PËR VITIN 2022

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2022”, i hartuar nga relatore znj. Brikena Ukperaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2022”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shumë mirë”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shumë mirë”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A Njohuritë ligjore.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*”– “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, natyrën juridike të saj dhe referencën relevante që gjen zbatim në zgjidhjen e çështjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- *Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:*

Gjyqtari, referuar natyrës së gjykimit (*kërkesë e seancës paraprake, kërkesë civile, civile themeli apo administrative me palë kundërshtare*), i kushton rëndësi përcaktimit të detajuar të fakteve të çështjes dhe përshkrimit të tyre në një ose disa pjesë të arsytimit të vendimit, në varësi të volumit të rrethanave të faktit apo natyrës së gjykimit sipas kërkesës objekt shqyrtimi. Gjyqtari subjekt vlerësimi i kushton një rëndësi të posaçme edhe ecurisë procedurale të çështjes, duke pasqyruar datën e regjistrimit të çështjes, shortimin apo rishortimin e saj, veprimet paraprake apo përgatitore të gjyqtarit si dhe çdo vendim të ndërmjetëm të marrë prej tij gjatë shqyrtimit të çështjes.

Në vendimin me objekt “*dërgimin e çështjes në gjyq*”, gjyqtari në pjesën e dytë të arsyetimit të titulluar “*rrethanat e çështjes*” përshkruan fillimisht kronologjinë e ngjarjes gjatë së cilës ka ndodhur fakti penal si dhe veprimet e kryera nga të pandehurit, duke i integruar provat me faktet e çështjes. Elementë të faktit penal bëhen pjesë e analizës së elementëve të figurës së veprës penale në pjesën e titulluar “*arsyetimi ligjor*”, duke i kushtuar një rëndësi specifike paraqitjes dhe listimit të fakteve thelbësore të çështjes.

Në vendimet burim vlerësimi të cilat lidhen me shqyrtimin e çështjeve të themelit (*civile, familjare ose administrative*) përshkrimi i fakteve me natyrë procedurale, shoqëruar me vlerësimin dhe analizën ligjore të gjykatës lidhur me këto elementë, posaçërisht në rastet kur ato konsistojnë në shqyrtimin e kërkesave procedurale të palëve, i jep qartësi vendimit dhe orienton lexuesin lidhur me elementë të tillë si: objekti i padisë, shkaku ligjor i saj, ndërgjyqësia, zhvillimin e gjykimit në prezencë ose mungesë të palëve, analizën e veprimeve të pajtimit, njoftimin e palëve konform nenit 133 të K.Pr.Civile, veçimin e objektit të padisë etj.

Në vendimin me objekt “*lëshimin e urdhrat të ekzekutimit*”, për shkak të vendimmarrjes së gjykatës për parashtrimin Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës tokësore, gjyqtari pasqyron në mënyrë sintetike rrethanat procedurale, pa u ndalur në faktet e çështjes.

Menjëherë pas përshkrimit dhe analizës së rrethanave me karakter procedural, gjyqtari subjekt vlerësimi parashtron rrethanat e faktit objekt gjykimi, në një nënndarje të titulluar “*rrethanat e çështjes*” si në çështjet seancë paraprake, ashtu edhe në çështjet civile, familjare dhe administrative, duke i parashtruar ato në mënyrë të qartë, në një rend logjik dhe kronologjik, dhe duke integruar në përmbajtje të faktit, provat përkatëse të analizuara në raport me njëra tjetrën. Në secilin vendim burim vlerësimi, faktet e çështjes janë përshkruar dhe analizuar në mënyrë tepër të detajuar dhe të plotë, duke u shoqëruar në çdo rast me paraqitjen dhe analizën e provave të administruara në gjykim, në mbështetje të konkluzioneve të gjyqtarit lidhur me provueshmërinë e fakteve thelbësore të çështjes.

- ***Identifikimi i natyrës së çështjes:***

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha vendimet e analizuara, referuar kategorisë së çështjes, natyra juridike e çështjes është e qartë dhe rezulton nga objekti i gjykimit (*kërkesë e seancës paraprake, kërkesë civile, civile themeli apo administrative me palë kundërshtare*), duke u evidentuar në disa raste në mënyrë të shprehur, si një element që orienton gjykatën në evidentimin e juridiksionit, kompetencën e gjykatës, detyrimin e gjykatës për njoftimin e kërkesës subjekteve procedurale (*të pandehurit, mbrojtësit të tij, si dhe të paditurve dhe Avokaturës së Shtetit*), analizën ligjore të çështjes, sipas natyrës së saj etj. Konkretisht në vendimin nr.137(49), datë 29.07.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë (*me objekt njohje pronar*) gjyqtari përcakton në mënyrë të qartë natyrën civile të çështjes duke vlerësuar se padia e

paditësit ka si shkak ligjor fitimin e pronësisë me parashkrim fitues pa titull të materializuar në nenin 169 të K.Civil. Në vendimin nr.208 (338), datë 09.05.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër (*me objekt shfuqizim vendimi*), gjyqtari përcakton natyrën administrative të çështjes, duke identifikuar dispozitat ligjore lidhur me kompetencën funksionale dhe tokësore, (*konkretisht nenet 7, 10 pika 1, 11 pika 1, të ligjit nr.49/2012*). Në vendimin nr.60, datë 05.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë (*me objekt njohje trashëgimtarë*), gjyqtari referuar natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar analizon se asnjë nga palët në gjykim nuk kanë statusin e një organi publik ose organi administrativ shtetëror, në mënyrë që zgjidhja e konfliktit midis tyre të mund të ishte nën juridiksionin në gjykatës administrative sipas parashikimeve të nenit 7 të K.Pr.Administrative. Në këtë kontekst gjyqtari ka analizuar se mosmarrëveshja është mosmarrëveshje *civile* gjykimi i së cilës i nënshtrohet rregullimeve të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.

- Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm:

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por lidhet gjithashtu me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes. Në këtë drejtim, referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se në të gjitha vendimet, gjyqtari identifikon qartë ligjin e zbatueshëm, citon dhe analizon dispozita të ligjit material ose procedural, në shërbim të analizës ligjore të tyre dhe ndërthurjes me elementet procedurale apo faktet e çështjes mbi të cilat zbatohen këto dispozita.

Sa i përket ligjit procedural penal, gjyqtari subjekt vlerësimi identifikon si ligj të zbatueshëm:

- (i) Dispozitat procedurale (*nenet 128, 259, 310, 321 pika , 332/b, 406/d pika 2, 471 pika dh, 98 pika 3, 99 pika 2, 112 pika 3, 122, 143, 158 pika 2, 171 pika 5, 172 pika 3, 245, 331 pika 2, 332/pika 2, 360 pika 3, 401 pika 2, 406/d pika 3, 406/e pika 2, 426 pika 2 të K.Pr.Penale*), lidhur me rastet e pavlefshmërisë absolute dhe relative të akteve si dhe afatin e ngritjes së pavlefshmërisë relative të akteve.
- (ii) Dispozitat procedurale (*nenet 32 pika 2, 151, 36-38, 52 pika 6, 87 pika 2, 154 pika 2 dhe 4, nenin 160 pika 5, 193 pika 3, 194, 201 pika 14, nenin 209 pika 9, 221 pika 5, 226 pika 2, 256 pika 3, 283 pika 3, 294/b pika 2 dhe 4, 296 pika 2 dhe 3, 322 pika 1, 324 pika 4, 362 pika 2 dhe 406/ë pika 3 të K.Pr.Penale*), lidhur me rastet e papërdorshmërisë së provave.
- (iii) Identifikon si dispozita të zbatueshme nenet 331, 327, 332/ë dhe “dh”, nenin 328 dhe 406 të K.Pr.Penale, lidhur me elementët e domosdoshëm të kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, si dhe përmbajtjen e fashikullit të gjykimit¹.

Gjithashtu, gjyqtari subjekt vlerësimi ka identifikuar si ligj të zbatueshëm *dispozita të pjesës së posaçme të Kodit Penal*, si:

¹ Vendim nr.40, datë 12.12.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë (*me objekt dërgimin në gjyq*).

- (i) Dispozitat materiale (*nenet 159 dhe 277 të K.Penal*) në funksion të cilësimit juridik të veprave penale, për të cilat akuzohet i pandehuri.

Sa i përket ligjit procedural civil të zbatueshëm, në vendimet civile, familjare dhe administrative të analizuara, gjyqtari subjekt vlerësimi identifikon saktë dispozitat procedurale. Konkretisht, gjyqtar subjekt vlerësimi identifikon dhe referon në pjesën arsyetuese të vendimit, dispozitat procedurale, si më poshtë:

- (i) Nenin 64 të K.Pr.Civile lidhur me detyrimin për pranimin e çështjes në gjykim në rastet e konfliktit të kompetencave.
- (ii) Nenet 43, 46, 47, 61, 62 dhe 125 të K.Pr.Civile lidhur me juridiksionit dhe kompetencës (*lëndore e tokësore*).
- (iii) (*Nenet 31, 32, të K.Pr.Civile*) lidhur me konceptin e padive dhe llojeve të saj.
- (iv) Nenet 16/1, 12 të K.Pr.Civile për të dhënë konsiderata të përgjithshme juridike lidhur me barrën e provës dhe parimeve të përgjithshme të gjykimit në procesin civil.
- (v) Nenet 7, 10 pika 1, 11 pika 1, të ligjit nr.49/2012, lidhur me kompetencën funksionale dhe tokësore të gjykatës.
- (vi) Nenin 25 pika 1 shkronja “b” të ligjit nr.49/2012, lidhur me veprimet paraprake të gjyqtarit.

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, në vendimet civile, familjare dhe administrative të analizuara, gjyqtari subjekt vlerësimi identifikon saktë dispozitat materiale në funksion të zgjidhjes së çështjes. Konkretisht, gjyqtari identifikon:

- (i) Nenet 83, 92, 149, 163, 164, 168, 169, 170, 191, 193, 304, 305, 312/2 dhe 313/2 të K.Civil, që normojë përkufizimin e veprimit juridik, rastet e pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik, konceptin juridik të pronësisë dhe mënyrat e fitimit të saj, posedimit, kontratës së shitjes dhe elementët e domosdoshëm të fitimit të pronësisë me parashkrim fitues me titull.
- (ii) Dispozitat e K.Civil (*nenet 149, 193/h, 199*), ligjin nr.49/2012 (*neni 17 i tij*), ligjin nr.33, datë 03.03.2012 “*Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme*” (*nenet 3, 24, 25, 37 pika 3 dhe 45*), Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.745, datë 24.10.2012 “*Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen.*”, Udhëzimin nr.2 të KM, datë 12.09.2012 “*Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrin të regjistruesit*”, K.Pr.Civile (*nenet 18, 90, 388, 510 të këtij kodi*).
- (iii) Nenin 15 të ligjit 49/2012, për të identifikuar rrethin e subjekteve që mund ti drejtohen gjykatës.
- (iv) Nenet 25 dhe 45 të ligjit nr.33/2012 dhe Udhëzimin nr.2, datë 12.09.2012 “*Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrin të regjistruesit*” si dhe nenet

83 dhe 193 të K.Civil, që normojnë veprimin juridik dhe detyrimin për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

- (v) Në vendimin nr.208 (338), datë 09.05.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër (*me objekt shfuqizim vendimi*), gjyqtari pasqyron një vështrim historik të legjislacionit në fushën e të drejtës së pronësisë, duke u nisur nga K.Civil i vitit 1929, i cili ka hyr në fuqi në datë 01.04.1929, duke identifikuar në mënyrë specifike nenin 794 të këtij Kodi. Në vijim identifikon Reformën Agrare të viteve 1945-1946, konkretisht ligjin “Për reformën agrare”, datë 29.08.1945, për të vijuar me pasqyrimin e ligjeve të miratuara në vitin 1955 (*Kodi Civil, Dekreti “Mbi pronësinë” dhe “Mbi sistemin agrar të tokave dhe regjistrimin e tyre”, ligji “Mbi pronësinë” etj.*). Citon neni 18 të Kushtetutës së vitit 1976, nenet 69,70 dhe 77 të K.Civil të vitit 1981, lidhur me konceptin e pronës shtetërore dhe private dhe kufizimet e tyre. Në vijim të pasqyrimin historik të legjislacionit të pronës gjyqtari identifikon ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, i cili shfuqizoi Kushtetutën e vitit 1976, ligjin nr.7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” i ndryshuar me ligjin nr.33/2012. Në vijim pasqyron përmbajtjen e nenit 41 të Kushtetutës aktuale që ka parashikuar fitimin e pronësisë me dhurim, trashëgimi, blerje dhe mënyrat e tjera të fitimit të pronësisë. Gjyqtari subjekt vlerësimi ndalet në parashikimin e nenit 25 dhe 37 të ligjit nr.33/2012 nën titullin “mënyrat e regjistrimit fillestar”.
- (vi) Nenet 1, 50, 51, 132, 143, 146 të K.Familjes, me qëllim dhënien e konsideratave të përgjithshme lidhur me institutin e martesës, shkaqet e zgjidhjes së martesës si dhe pasojat juridike në rastin e zgjidhjes së martesës.
- (vii) Nenet 772-783 të Kodit Civil lidhur me kuptimin e kontratës së furnizimit dhe natyrës juridike të saj. Në vijim gjyqtari identifikon nenet 419, 420, 663, të K.Pr.Civile për të dhënë konsiderata të përgjithshme juridike lidhur me përkufizimin e marrëdhënies juridike së detyrimit dhe kushtet thelbësore të kontratës.
- (viii) Nenet 80 pika 3, 5 dhe 122 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, që normojnë kontrollin tatimor dhe kundërvajtjet administrative në përdorimin e pajisjeve fiskale për lëshimin e kuponëve fiskalë e të biletave.
- (ix) Nenet 2, 37 pika 1, 115, 116 të ligjit nr.8485, datë 12 Maj 1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, lidhur me pavlefshmërinë absolute dhe relative të aktit administrativ, kuptimin e aktit administrativ, institutin e barrës së provës etj.

Sa i përket aspektit të evidentimit të konfliktit të normave, në vendimet e analizuara nuk rezulton të jetë evidentuar ndonjë rast i konfliktit të normave me karakter procedural ose material.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtari subjekt vlerësimi ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes dhe përshkrimin e tyre duke i ndërthurur me provat e administruara në gjykim. Ai ka aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim mbi faktin objekt shqyrtimi. Identifikimi dhe përcaktimi nga gjyqtari, në mënyrë të qartë i faktit juridik që përbën objektin e gjykimit, orienton mënyrën e paraqitjes së fakteve, analizën e provave dhe analizën ligjore të çështjes në vijim të arsytimit të vendimit, analizë e cila është e ndryshme në bazë të objektit të gjykimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Normat ligjore procedurale dhe materiale, identifikohen, interpretohen dhe aplikohen mbi faktin, në shërbim të konkluzionit të arritur nga gjyqtari në lidhje me zbatimin e tyre.

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përgjithësisht identifikimi i normës juridike (*procedurale dhe materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar në çdo rast me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes, si në ato me natyrë procedurale ashtu edhe në ato që kanë lidhje me themelin e çështjes. Tipar karakteristik i gjyqtarit është se në çdo rast citimi ose referimi i dispozitave është shoqëruar me interpretimit të tyre në mënyrë abstrakte dhe individuale, para aplikimit mbi faktin konkret ose konkluzionin e arritur. Konstatohet se gjyqtari kryesisht përdor interpretimin teleologjik të normës konkrete duke identifikuar qëllimin e saj, por edhe interpretimin literal apo sistematik të normave, interpretim i cili duke e përqasur me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, sjell si pasojë logjike konkluzionin e tij në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:

Në vendimet civile dhe penale interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj, duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative ose alternative, që të gjejnë zbatim norma konkrete, por edhe në përputhje me faktin dhe provat e administruara në gjykim. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi rezulton se gjyqtari:

- (i) Interpreton në mënyrë sistematike dispozitat materiale (*nenet 149, 296, 302 dhe 304 të K.Civil*), lidhur me konceptin e pronësisë dhe mënyrat e fitimit të saj.

- (ii) Interpreton nenet 168 dhe 169 të K.Civil, dispozita të cilat normojnë institutin e parashkrimit fitues. Në këtë kontekst rezulton se gjyqtari referon në vendimin nr.4, datë 23 shkurt 2016 të Gjykatës Kushtetuese, vendim në të cilin është rrëzuar kërkesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për shfuqizimin si antikushtetues të nenit 169 të K.Civil.
- (iii) Interpreton nenin 169 të K.Civil, lidhur me elementët e domosdoshëm të fitimit të pronësisë me parashkrim fitues pa titull. Në këtë kontekst rezulton se gjyqtari merr në analizë në mënyrë të detajuar çdo element-kriter të domosdoshëm për të qenë para parashkrimit fitues me titull. Duke analizuar kriterin e posedimit të qetë e të pandërprerë për një periudhë jo më pak se 20 vjet gjyqtari interpreton nenet 312/2 dhe 313/2 të K.Civil, në të cilat normohen paditë posedimore. Gjithashtu, gjyqtari interpreton në mënyrë literale nenin 304 të K.Civil, duke dhënë përkufizimin e posedimit dhe kategorizimet juridike të këtij instituti.²
- (iv) Interpreton nenet 25 dhe 45 të ligjit nr.33/2012 dhe Udhëzimin nr.2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” lidhur me detyrat e zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.
- (v) Interpreton në mënyrë sistematike nenet 17, 2 pika 2 dhe 39 të ligjit nr.49/2012 lidhur me pasojën juridike të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, i cili nuk përbën akt administrativ e për pasojë kërkimi i palës paditëse nuk mund të paraqitet gjyqësisht në gjykatën administrative.³
- (vi) Interpreton në mënyrë sistematike dispozitat materiale dhe dispozitën kushtetuese (*nenet 1 dhe 50 të K.Familjes si dhe nenin 53 të Kushtetutës*), në funksion të analizimit të institutit të martesës.
- (vii) Interpreton dispozitat materiale, konkretisht nenet 125, 129, 132 të K.Familjes lidhur me mbarimin e martesës nëpërmjet një prej formave të saj (*konkretisht zgjidhjes së saj*), duke u ndalur në mënyrë të veçantë te neni 132 i K.Familjes.
- (viii) Interpreton nenin 146/1 të K.Familjes në lidhje me pasojat juridike të zgjidhjes së martesës ndërmjet bashkëshortëve, konkretisht me ndryshimin e mbiemrit të bashkëshortit tjetër si një ndër pasojat *ipso lege* të zgjidhjes së martesës në rastin konkret.⁴
- (ix) Në lidhje me ekzistencën e përgjegjësisë penale dhe cilësimin juridik të faktit penal rezulton se gjyqtari interpreton nenet 159 dhe 277 të K.Penal, duke analizuar 4 elementët e domosdoshëm për ekzistencën e figurës së veprës penale.⁵
- (x) Interpreton në mënyrë logjike dhe të ngushtuar (*stricto sensu*) nenin 420 të K.Civil dhe në mënyrë sistematike me nenin 419 të K.Civil në funksion të argumentit se marrëdhënia juridike e detyrimit lind nga kontrata, e cila përfaqëson një veprim juridik të dyanshëm, si dhe nga ligji në rastet tekstuale të parashikuara në Kodin Civil.⁶

² Vendim nr.137(49), datë 29.07.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë (*me objekt njohje pronar*).

³ Vendim nr.208 (338), datë 04.04.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër (*me objekt shfuqizim vendimi*)

⁴ Vendim nr.34, datë 13.05.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë (*me objekt zgjidhje martese*)

⁵ Vendim nr.40, datë 12.12.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë (*me objekt dërgimin në gjyq*)

⁶ Vendim nr.60, datë 04.10.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë (*me objekt përmbushje detyrimi kontraktor*)

- (xi) Interpreton nenin 80 pika 3, të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore” duke analizuar qëllimin e kontroleve tatimore për zbulimin e shkeljeve që kanë lidhje me regjistrimin e personave të tatueshëm.
- (xii) Interpreton nenet 115, 116 të ligjit nr.8485, datë 12 Maj 1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, lidhur me kuptimin e aktit administrativ, pavlefshmërinë absolute dhe relative të aktit administrativ.⁷
- (xiii) Interpreton në mënyrë sistematike dispozitën kushtetuese (nenin 42/2), lidhur me të drejtën e subjekteve për t’ju drejtuar gjykatës për rivendosjen e të drejtave të pretenduara si të shkelura me nenin 15 të ligjit 49/2012, për të identifikuar rrethin e subjekteve që mund ti drejtohen gjykatës.
- (xiv) Interpreton në mënyrë sistematike nenin 18 të Kushtetutës së vitit 1976 (nenin 18 të saj) me nenet 69, 70 dhe 77 të K.Civil të vitit 1981, lidhur me konceptin e pronës shtetërore dhe private dhe kufizimet e tyre.
- (xv) Interpreton dispozitat kushtetuese (nenet 155 dhe 157 të saj) në mënyrë të përgjithshme duke evidentuar rolin e shqyrtimit të veprimtarisë administrative, qëllimin e vendosjes së rregullave për garantimin e mbledhjes së tatimeve, burimet e krijimit të të ardhurave të buxhetit të shtetit etj.

Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale civile dhe penale, gjyqtari përgjithësisht i jep rëndësi interpretimit të normës, si në rastet kur trajtohen çështje të procedurës, ashtu edhe në rastet kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel, si p.sh në kërkesat civile për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, apo në çështjen civile dhe administrative. Konkretisht, nga vendimet gjyqësore burim vlerësimi rezulton se gjyqtari:

- (i) Interpreton nenin 11 të K.Pr.Civile, lidhur me konceptin juridik të provave.⁸
- (ii) Interpreton dispozitat procedurale (nenet 128, 128/a, 259 dhe 310 të K.Pr.Penale), lidhur me pavlefshmërinë absolute të akteve duke u ndalur në mënyrë specifike te rastet e pavlefshmërisë absolute kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me thirrjen e të pandehurit, viktimës apo praninë e mbrojtësit, kur ajo është e detyrueshme. Gjithashtu, gjyqtari interpreton nenin 128 dhe 129 të K.Pr.Penale, në funksion të analizimit të pavlefshmërisë relative të akteve, mënyrën dhe afatin e ngritjes së kësaj pavlefshmërie, duke bërë dallimin e kësaj pavlefshmërie me pavlefshmërinë absolute të akteve. Në këtë kontekst, gjyqtari evidenton se rastet e pavlefshmërisë relative të akteve janë të sanksionuara në dispozita të ndryshme të K.Pr.Penale, duke i listuar këto dispozita.
- (iii) Interpreton në mënyrë sistematike dispozitat kushtetuese dhe procedurale (nenet 32 pika 2 dhe 151 të K.Pr.Penale) lidhur me përdorshmërinë e provave duke listuar rastet e parashikuara në mënyrë eksplicite në K.Pr.Penale.⁹

⁷ Vendimin nr.302 (447), datë 09.05.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër (me objekt pavlefshmërinë e aktit administrativ)

⁸ Vendim nr.137(49), datë 29.07.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë (me objekt njohje pronar).

⁹ Vendim nr.40, datë 12.12.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë (me objekt dërgimin në gjyq).

- (iv) Interpreton në mënyrë sistematike nenet 31 dhe 32 të K.Pr.Civile, në funksion të analizimit të konceptit të padisë dhe llojeve të tyre.
- (v) Në mënyrë specifike, gjyqtari ndalet në interpretimin e pikës b dhe c të nenit 32 të K.Pr.Civile, duke analizuar natyrën juridike të padisë për vërtetimin e qenies ose mosqenies së një marrëdhënie juridike/të drejte apo për njohjen e vërtetësisë apo pavërtetësisë së një dokumenti.¹⁰
- (vi) Interpreton në mënyrë sistematike nenet 12 dhe 16/1 të K.Pr.Civile, lidhur me parimet e përgjithshme të procesit civil dhe në mënyrë specifike në funksion të argumentimit dhe analizimit të konceptit juridik të barrës së provës.¹¹
- (vii) Interpreton në mënyrë sistematike nenet 37 pika 1 dhe 35 pika 1 të ligjit nr.49/2012 lidhur me barrën e provave në procesin administrativ.¹²

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, rezulton se gjyqtari ka respektuar elementet e procesit të rregullt ligjor dhe të drejtat e palëve, duke iu krijuar atyre mundësi të marrin pjesë në gjykim, të dëgohen, të kërkojnë marrjen e provave, të debatojnë mbi provat, të kenë asistencën e mbrojtësit, etj. Në një vendim (*me objekt shfuqizim vendimi*), gjyqtari analizon parimet bazë të regjistrimit si regjim imponues, konkretisht parimin e deklarimit dhe parimin e prioritetit. Në lidhje me këtë të fundit gjyqtari analizon pasqyrimin e tij edhe në nenin 37 të ligjit nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (*përparësia e pronave*). Po në këtë vendim gjyqtari referon në parimin e procesit të rregullt ligjor dhe sigurisë juridike.

Në vendimin e përzgjedhur me short me objekt “*zgjidhje martesë*” rezulton se gjyqtari referon në parimin e autonomisë së vullnetit të palëve në lidhjen e martesës.

Në një tjetër vendim burim vlerësimi të përzgjedhur me short me objekt: “*përmbushje detyrimi kontraktor*” rezulton se gjyqtari interpreton në mënyrë sistematike nenet 12 dhe 16/1 të K.Pr.Civile, lidhur me parimet e përgjithshme të procesit civil dhe në mënyrë specifike në funksion të argumentimit dhe analizimit të konceptit juridik të barrës së provës.

Në lidhje me aftësinë për të përdorur jurisprudencën relevante: Gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante në mbështetje të argumenteve të tij në lidhje me interpretimin e ligjit dhe aplikimin e tij mbi faktet. Konkretisht, në lidhje me këtë tregues konstatohet se:

- (i) Gjyqtari subjekt vlerësimi duke interpretuar nenet 168 dhe 169 të K.Civil, dispozita të cilat normojnë institutin e parashkrimit fitues, referon në vendimin nr.4, datë 23 shkurt 2016 të Gjykatës Kushtetuese, vendim në të cilin është rrëzuar kërkesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për shfuqizimin si antikueshtetues të nenit 169 të K.Civil.
- (ii) Në funksion të qëndrimit se regjimi i transkriptimit realizohet nëpërmjet mbajtjes së regjistrimit publik, i cili ka për objekt aktet që krijojnë, ndryshojnë ose përfundojnë të drejta

¹⁰ Vendim nr.60, datë 05.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë (*me objekt njohje trashëgimtarë*).

¹¹ Vendim nr.60, datë 04.10.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë (*me objekt përmbushje detyrimi kontraktor*).

¹² Vendim nr.302 (447), datë 09.05.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër (*me objekt pavlefshmërinë e aktit administrativ*).

reale mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, gjyqtari pasqyron një pjesë të Vendimit Unifikues nr.1/2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

- (iii) Gjyqtari subjekt vlerësimi duke analizuar parimet bazë të regjistrimit si regjim imponues, konkretisht parimin e deklarimit dhe parimin e prioritetit pasqyron një pjesë të Vendimit nr.2/2010 të Gjykatës Kushtetuese, lidhur me respektimin e hierarkisë së akteve dhe përparësisë në rastin e konfliktit të normave.
- (iv) Në funksion të qëndrimit se nëse e drejta për një proces të rregullt ligjor do të cenohej nëse refuzimi i regjistrimit të titullit të pronësisë do të bëhej nga ana e ZRPP me një akt të sajin pa u bazuar në një vendim gjyqësor, gjyqtari pasqyron një pjesë të vendimit nr.17/2010 të Gjykatës Kushtetuese.
- (v) Në kuadër të analizimit të veprës penale të “Vetëgjyqësisë” rezulton se gjyqtari referon në Vendimin Unifikues nr.1, datë 25 .03.2005, vendim në të cilin është unifikuar qëndrimi në lidhje me veprat penale të “Heqjes së paligjshme të lirisë”, “Rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit” dhe “Vetëgjyqësisë”. Gjithashtu për të konkluduar nëse veprimet e të pandehurit përbëjnë elementë të veprës penale të “Vetëgjyqësisë” si dhe për të analizuar konkurrimin e veprave penale rezulton se gjyqtari referon dhe zbaton përfundimet e nxjerra nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në Vendimin Unifikues nr.3, datë 02.11.2015.
- (vi) Në funksion të argumentit juridik se paraqitja e provave në një proces gjyqësor i shërben hetimit të plotë dhe të gjithanshëm, por njëkohësisht tregon nevojshmërinë për ndarjen dhe caktimin e objektit të të provuarit kundrejt palëve ndërgjyqëse, gjyqtari referon në vendimin nr.11211-03242-00-2012 Regj.Them, 888 Vendimi (10), datë 20.01.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Veç sa më sipër, në Vendimin Nr. 52-2022-253 dt. 12.12.2022 konstatohet se interpretimi që gjyqtari i bën kompetencave të parashikuara në ligj për gjyqtarin e seancës paraprake, të parashikuara nga nenet 332/dh në lidhje me nenin 328 pika 1 të K.Pr.Penale, nuk përputhet me jurisprudencën relevante të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Pavarësisht se vlerësuesi nuk ndërhyr në bindjen e brendshme të gjyqtarit dhe mënyrën e interpretimit prej tij të ligjit të zbatueshëm, çka vlerësohet vetëm nga një gjykatë më e lartë, dukshëm konstaton në këtë vendim që jurisprudenca relevante e Gjykatës së Lartë mbi kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake kur shqyrton çështje me objekt : “Dërgim për gjyq”, nuk rezulton të gjejë zbatim. Konkretisht gjyqtari arsyeton: “ *...Prandaj Gjykata çmon se, përpara se të merret vendimi për dërgimin e çështjes në gjyq, gjyqtari i seancës paraprake ka detyrimin të analizojë kryesisht nëse kjo kërkesë është e bazuar në prova dhe në ligj si nga pikëpamja e mjaftueshmërisë së provave, ashtu dhe nga pikëpamja e përdorshmërisë së tyre dhe vlefshmërisë së akteve procedurale (absolute kryesisht dhe relative me kërkesë të palëve). Gjithashtu gjykata duhet të analizojë ekzistencën e faktit penal dhe lidhjen e të pandehurit me këtë fakt penal si dhe faktin nëse cilësimi juridik i bërë nga prokuroria e faktit penal është i drejtë.....” Duke interpretuar në këtë mënyrë ligjin procedural mbi kompetencat e gjyqtarit të hetimit paraprak, në vijim të arsyetimit, në një nënndarje të veçantë të vendimit të titulluar “ *Lidhur me ekzistencën e përgjegjësisë penale dhe cilësimin juridik të faktit penal*”, pasi analizon 4 elementet e veprës penale të*

parashikuar nga neni 159 i K.Penal konkludon : “.... Bazuar në këtë analizë të katër elementëve bazike që konfigurojnë cilësimin juridik të kësaj vepre penale, gjykata krijon bindjen se në rastin konkret i pandehuri A.Q lidhet ngushtësisht me këta elementë dhe e bën atë përgjegjës për konsumimin e kësaj vepre penale. Prandaj gjykata vlerëson se cilësimi ligjor “shkatërrimi i rrjetit të ujësjellësit” sipas paragrafit të parë të Kodit Penal në ngarkim të të pandehurit A.Q është i saktë, i bazuar në ligj e në prova”. Në vijim të arsyetimit të të njëjtit vendim pasi analizon elementët e veprës penale të “Vetëgjyqësisë” dhe referon drejt Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3/2015, shprehet : “.....në rastin në shqyrtim, veprimet e kryera nga i pandehuri nuk kanë si qëllim mbrojtjen e një të drejte apo interesi të ligjshëm. I pandehuri A.Q ka kryer veprimin e kundërligjshëm të rilidhjes së ujit të pijshëm, me qëllim që të furnizonte me ujë të pijshëm aktivitetin e tij privat XX. Ai është në dijeni të faktit se nuk ka një kontratë furnizimi me ujë të pijshëm me Ujësjellës Kanalizime Fushë-Arrëz, por është nëna e tij palë kontraktore me viktimën nga vepra penale.....Prandaj gjykata në bazë të nenit 328 pika 1 shkronja “b” të Kodit të Procedurës Penale konkludon në pushimin e akuzës, për shkak se veprimet e kryera nga i pandehuri për rilidhjen e ujit të pijshëm të ndërprerë nga punonjësit e Ujësjellës Kanalizime Fushë Arrëz, nuk përbëjnë kundërvajtjen penale të vetëgjyqësisë parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, por të shkatërrimit të rrjetit të ujësjellësit të parashikuar nga neni 159 paragrafi i parë i Kodit Penal”.

Arsyetimi i mësipërm mbi ligjin procedural të zbatueshëm dhe zbërthimi që gjyqtari i bën elementëve të tij, çka ka orientuar më pas dhe disponimin e tij mbi çështjen në shqyrtim, duke marrë në thelb kompetencat e gjyqtarit të themelit, nuk përputhet me jurisprudencën relevante, konkretisht me qëndrimet e konsoliduara të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në vendimet : nr. 00-2022-978 (215) dt. 26.07.2022; 00-2022-1491 (314) dt. 22.11.2022; nr. 00-2022-795 (185) dt. 05.07.2022; nr.00-2022-1188 (250) dt. 29.09.2022; nr.00-2022-121 (37) dt. 28.01.2022; nr.00-2022-796 (184) dt. 28.06.2022 dhe ai nr. 00-2022-581 (160) dt. 09.06.2022.

Lidhur me këtë tregues gjyqtari, ka paraqitur kundërshtime duke parashtruar se në lidhje me këtë përfundim, ndan një mendim ndryshe nga relatorja sepse, pushimi i akuzës nga gjyqtari i seancës paraprake përbën një kompetencë të parashikuar nga ligji procedural penal edhe për gjyqtarin e seancës paraprake, duke cituar këtu përmbajtjen e dispozitave procedurale konkretisht të neneve 332/dh, pika 1 shkronja “ç” dhe nenin 328 të K.Pr.Penale. Gjithashtu gjyqtari parashtron se përfundimi bazuar vetëm një dosje gjyqësore, kur janë vlerësuar shumë të tilla, për nivelin e vlerësimit mbi mesataren, nuk është i drejtë, për arsye se: a) Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, duke filluar nga neni 332 e vijues i tij, janë shtuar dhe ndryshuar në vitet 2017 dhe 2021, çka ka sjellë vështirësi kuptimi dhe interpretimi për të gjithë gjyqtarët; b) Mungesën e qëndrimit njësoj të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në lidhje me të drejtën ligjore të gjyqtarit të seancës paraprake për të vendosur pushimin e akuzës apo të çështjes dhe raportit me gjyqtarin e themelit; c) Shqyrtimi në të njëjtën kohë në fushat: administrative, civile dhe penale. Duke kërkuar në përfundim vlerësimin për këtë tregues në nivelin “Shumë mirë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, në vendimet përfundimtare, përgjithësisht interpretimi i dispozitave ligjore, përveç analizës abstrakte dhe zërthimit të kuptimit të tyre, para aplikimit mbi faktet konkrete, pasurohet me referimin në praktikën unifikuese/njësuese të Gjykatës së Lartë, si dhe në aplikimin e parimeve të së drejtës. Por e njëjta shkallë kujdesi nuk evidentohet në çështjen penale me objekt “Dërgim në gjyq”, ku interpretimi i dispozitave ligjore e zbatimi i tyre mbi faktet objekt gjykimi, nuk mbështetet në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë mbi kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake e ndryshimin e tyre nga ato të gjyqtarit të themelit.

Këshilli vlerëson se kundërshtimet e gjyqtarit lidhur me këtë tregues nuk vlerësohen të tilla që të përlligjin vlerësimin e tij maksimal, sepse pavarësisht se bëhet fjalë vetëm për 1 dosje gjyqësore, ajo është tregues i aftësisë së gjyqtarit për të interpretuar ligjin procedural në të gjitha çështjet e të njëjtit lloj. Mungesa e vendimit njësuës nuk mund të përdoret si argument në rastin konkret, pasi praktika e njëjtë dhe e konsoliduar e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake në çështjet me objekt “Dërgim për gjyq”, është e detyrueshme për tu zbatuar nga gjykatat më të ulëta. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, brenda treguesit të “Aftësisë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, vlerësohet gjithashtu aftësia e gjyqtarit për të analizuar jurisprudencën, duke u përqendruar tek aftësia për të kërkuar, identifikuar, organizuar dhe përdorur jurisprudencën relevante për një çështje të caktuar. Në veçanti vlerësohet nëse gjyqtari i referohet dhe menaxhon me efikasitet, në vendin e duhur dhe sipas llojit të qëllimit të aktit, praktikën e konsoliduar gjyqësore....etj.

Duke vlerësuar në tërësi metodologjinë e punës së gjyqtarit dhe aftësinë e tij në drejtim të kërkimit, gjetjes dhe përdorimit të jurisprudencës relevante, nuk rezultojnë e njëjta shkallë kujdesi në të gjitha vendimet gjyqësore të analizuar, çka e bën aftësinë e tij për këtë tregues të jetë e shkallës “Mbi mesatare”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Mbi mesataren”, duke u pikëzuar me 20 pikë.

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Shkrimi ligjor duhet të karakterizohet nga disa tipare që e bëjnë të qëndrueshëm, siç janë: qartësia, saktësia, konciziteti dhe komponenti analitik. Ai duhet të paraqesë pa ndërprerje një pamje të qartë, të shpejtë dhe të plotë të çështjes. Vendimi gjyqësor nuk duhet të dominohet nga përshkrimi i provave, por nga pjesa analitike, e cila në vetvete duhet të jetë koncize, pa përsëritje dhe të trajtojë çështjet thelbësore.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se, gjuha e përdorur nga gjyqtari në komunikimin me palët gjatë gjykimit dhe në aktet procedurale të dosjeve të analizuara është në çdo rast e thjeshtë, e drejtpërdrejtë, e qartë për palët në proces, si dhe për lexuesin e akteve. Gjyqtari përdor të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe, respekton rregullat gramatikore dhe ato të sintaksës në formimin e fjalëve dhe fjalive, duke i bërë aktet të qarta dhe të shkruara në mënyrë korrekte. Referimi i parimeve të së drejtës në gjuhën latine, është shoqëruar me dhënien e kuptimit të tyre në gjuhën shqipe, duke mos krijuar paqartësi lidhur me kuptimin dhe zbatimin e tyre. Gjyqtari përdor përgjithësisht fjali me gjatësi mesatare, të cilat janë të qarta dhe të organizuara në rrjedhë logjike të njëra tjetrës si dhe paragrafë të strukturuar, të cilët janë të lidhur me njëri-tjetrin duke treguar vijueshmëri të arsyetimit.

Në të gjitha vendimet e vëzhguara, nuk rezultojnë të jenë përdorur terma teknikë apo fjalë që krijojnë konfuzion në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit në arsyetimin e vendimeve, përgjithësisht tregon qartësinë dhe vijueshmërinë e mendimit duke i bërë vendimet të kuptueshme.

Lidhur me komponentin e “përzgjedhjes së kujdesshme të gjuhës” në vendimin gjyqësor nr.52-2022-232 dt.16.11.2022, ku prej gjyqtarit disponohet “për parashtrimin e mosmarrëveshjes në lidhje me kompetencën tokësore” gjyqtari shprehet : “ *Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë çmon se vendimi gjyqësor nr.803 (3767) datë 20.09.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që, kryesisht ka shpallur moskompetencën tokësore për shqyrtimin e çështjes, është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit. Ajo gjykatë në arsyetimin e vendimit ka marrë kryesisht në shqyrtim faktin nëse është kompetente nga pikëpamja tokësore për shqyrtimin e çështjes objekt gjykimi apo jo, pa patur kërkesë nga pala kërkuese*”.

Në drejtim të qartësisë së disponimeve në dispozitivin e vendimit gjyqësor nr. 52-2022-287 (60) dt. 04.10.2022, konkretisht në pikën 3 të tij, konstatohet që prej gjyqtarit të jetë disponuar : “*Detyrimin e palës së paditur “RTM” shpk që t’i paguajë palës paditëse “VTO” shpk kamatëvonesat ligjore për shkak të moslikudimit në kohë të këtyre faturave*”. Pavarësisht se në pjesën arsyetuese gjyqtari ka shpjeguar arsyen pse ka pranuar pretendimin e pagimit të kamatëvonesave për faturat tatimore të palikujduara në kohë nga pala e paditur, duke parashikuar kohën e fillimit të pagimit të tyre për çdo faturë si dhe mënyrën e llogaritjes, në dispozitivin e vendimit, i cili duhet të tregojë qartë çdo detyrim të palës së paditur, nuk gjendet e shkruar në mënyrë të qartë ajo çka është pasqyruar në arsyetimin e vendimit dhe as momenti deri kur nga përmbaruesi duhet të llogariten këto kamatëvonesa.

Në drejtim të komponentit të “koncizitetit”, kryesisht në çështjet e një natyre më komplekse se të tjerat, sikundër janë vendimi gjyqësor nr.208 (338) dt. 04.04.2022 (vendim i zgjedhur nga gjyqtari) dhe vendimi nr. 137 (49) dt. 29.07.2022 (vendim edhe ky i zgjedhur nga vetë gjyqtari), konstatohet lehtësisht në mënyrën e të shkruarit të gjyqtarit, zgjatja e mendimit tek pjesa përshkruese, kryesisht tek pasqyrimi i pretendimeve të palëve. Këto të fundit në shumicën e

rasteve nuk përmbliidhen, madje disa herë pasqyrohen në vetën e parë. Kujdesi që gjyqtari tregon në pasqyrimin e të gjitha pretendimeve të palëve mbingarkon pjesën përshkruese të vendimit, me përsëritje faktesh apo rikthim në prova që janë pasqyruar një herë tek paraqitja e fakteve të çështjes. Gjyqtari duhet të tregojë aftësi në paraqitjen e përmbledhur të pretendimeve të palëve sepse gjithpërfshirja dhe saktësia e paraqitjes së çdo pretendimi nuk nënkupton ricitim në vendim të gjithë përmbajtjes së diskutimit përfundimtar të palëve.

Lidhur me këtë tregues gjyqtari, ka paraqitur kundërshtime duke parashtruar se *përdorimi i togfjalëshit “është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit”, ka lidhje me dispozitën ligjore konkrete procedurale ku përcaktohet se çështja e kompetencës tokësore nuk merret në shqyrtim kryesisht nga gjykata, si dhe në qëndrimin e konsoliduar të Gjykatës së Lartë në këtë drejtim. Gjithashtu, togfjalëshi i sipërcituar i përdorur në vendimin gjyqësor nr. 52-2022-232, datë 16.11.2022, nuk është rilevant për kategorinë e vlerësuar: qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.*

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari përgjithësisht i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimeve në drejtim të kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi nuk evidentohet në drejtim të “përzgjedhjes së kujdesshme të gjuhës” “qartësisë së disponimeve në dispozitivin e vendimit” dhe “koncizitetit të pjesës përshkruese, nënndarjes pretendimet e palëve”. Theksimi i tepruar i hollësive dhe tendenca për të pasqyruar në vendim çdo diskutim të palëve, zbeh evidentimin e çështjeve që kanë përbërë thelbin e pretendimeve objekt padie apo prapësimeve në gjykim.

Referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari ka aftësi mbi mesatare në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Lidhur me kundërshtimet e gjyqtarit Këshilli ndan të njëjtin qëndrim si relatorja, pasi pavarësisht mendimit, interpretimit të ligjit dhe bindjes së brendshme të gjyqtarit lidhur me gjykatën kompetente, kur janë gjykata të të njëjtit nivel, gjyqtari i shkallës së parë duhet të tregohet i kujdesshëm në mënyrën e të shkruarit në vendimin gjyqësor dhe në përzgjedhjen e fjalëve, pa bërë ai vetë gjykatën më të lartë. Në këtë rast togfjalëshi i përdorur “*është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit...*”, nuk tregon përzgjedhje të kujdesshme të gjuhës nga gjyqtari i së njëjtës shkallë me gjyqtarin që ka shpallur moskompetencën, pavarësisht qëndrimin të Gjykatës së Lartë lidhur me mosmarrëveshjen e krijuar mes dy gjykatave të shkallës së parë lidhur me kompetencën tokësore të shqyrtimit të kërkesës me objekt “lëshim urdhër ekzekutimi”. Gjyqtari i shkallës së parë në këtë rast duhet të shprehet në mënyrë të tillë që të tregojë respekt për mendimin e kolegut, pavarësisht se vetë ai mund të ndajë qëndrim të ndryshëm, shkak për të cilin i drejtohet Gjykatës së Lartë për të zgjidhur mosmarrëveshjen e kompetencës. Vetëm kjo e fundit mund të vendosë se cili nga vendimet është apo jo i bazuar në ligj.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Mbi mesataren” duke u pikëzuar me 12 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.

Në 2 (dy) vendimet gjyqësore që i nënshtrohen kësaj analize, konstatohet se gjyqtari subjekt vlerësimi ndjek në hartimin e tyre një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës gjyqtari i përmbahet si prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjithashtu, konstatohet se gjyqtari në rastin konkret ka një metodologji të qartë sipas pjesëve përbërëse të vendimit. Konkretisht, në mënyrë më specifike konstatohet se: Vendimi gjyqësor përmban pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

Në pjesën hyrëse gjejmë pasqyrim të dhënave të regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, si dhe kërkimet e subjekteve të pranishme në proces.

Pjesa përshkuese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë dhe të listuara formalisht si procedura gjyqësore, rrethanat e faktit, pretendimet e palëve, legjislacioni i zbatueshëm dhe vlerësimi dhe analiza juridike, në të cilën në mënyrë të detajuar analizon: (i) rrethanat procedurale të çështjes dhe çdo vendimmarrje të ndërmjetme të gjykatës; (ii) rrethanat e fakteve të çështjes të integruara me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, (iii) ligjin e zbatueshëm duke u ndalur tek dispozitat materiale civile (administrative) por edhe ato procedurale në funksion të disponimit të gjykatës dhe (iv) pretendimet e palëve (në mënyrë të detajuar); (v) vlerësimi i gjykatës në të cilën gjykata merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarit dhe konkluzionin e tij.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës për rrëzimin e padisë dhe data e shpalljes së vendimit. Konstatohet gjithashtu se dispozitivi i vendimit është i plotë dhe në të gjejmë pasqyrim disponimi i gjykatës mbi rrëzimin e padisë. Gjithashtu në vendimet objekt vlerësimi konstatohet disponimi i gjykatës mbi shpenzimet gjyqësore, si dhe të drejtën e ankimit ndaj vendimit.

Konstatohet se vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile. Po kështu të dy vendimet e për zgjedhura janë të strukturuar në paragrafë me qëllim që palët të kuptojnë konkluzionin dhe arsyetimin e gjykatës për çdo pretendim të ngritur në ankim, në funksion të vendimmarrjes përfundimtare.

Referuar 6 vendimeve të dhëna prej gjyqtarit në çështjet gjyqësore të përzgjedhura me short,
konstatohet se:

Në 6 vendimet gjyqësore që i nënshtrohen kësaj analize, konstatohet se gjyqtari subjekt vlerësimi ndjek në hartimin e tyre një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës gjyqtari i përmbahet si prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjithashtu, konstatohet se gjyqtari në rastin konkret ka një metodologji të qartë sipas pjesëve përbërëse të vendimit. Konkretisht, në mënyrë më specifike konstatohet se: Vendimi gjyqësor përmban pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, si dhe kërkimet e subjekteve të pranishme në proces.

Pjesa përshkuese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë dhe të listuara formalisht si procedura gjyqësore, rrethanat e faktit, pretendimet e palëve, legjislacioni i zbatueshëm dhe vlerësimi dhe analiza juridike, në të cilën në mënyrë të detajuar analizon: (i) rrethanat procedurale të çështjes dhe çdo vendimmarrje të ndërmjetme të gjykatës; (ii) rrethanat e fakteve të çështjes të integruara me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, (iii) ligjin e zbatueshëm duke u ndalur tek dispozitat materiale civile (administrative) por edhe ato procedurale në funksion të disponimit të gjykatës dhe (iv) pretendimet e palëve (në mënyrë të detajuar); (v) vlerësimi i gjykatës në të cilën gjykata merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarit dhe konkluzionin e tij.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës dhe data e shpalljes së vendimit. Gjithashtu në vendimet objekt vlerësimi konstatohet disponimi i gjykatës mbi shpenzimet gjyqësore si dhe të drejtën e ankimit ndaj vendimit.

Konstatohet se vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, elementët e parashikuar në: (i) nenin 310 të K.Pr.Civile, në vendimet civile dhe familjare, (ii) nenin 260 të K.Pr.Penale, në vendimin e kërkesës së hetimeve paraprake, (iii) nenin 332/e dhe 329/b të K.Pr.Penale, në vendimet seancë paraprake. Po kështu, të gjitha vendimet e përzgjedhura me short janë të strukturuar në paragrafë me qëllim që palët të kuptojnë konkluzionin dhe arsyetimin e gjykatës për çdo pretendim të ngritur në ankim, në funksion të vendimmarrjes përfundimtare.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukturë të qëndrueshme dhe të mirë

organizuar të vendimit e cila është e dukshme në aspektin vizual dhe të përmbajtjes, duke i dhënë qëndrueshmëri dhe kuptueshmëri vendimit. Ndjekja e një strukturë të njëjtë, të mirë përcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” është “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitiv të vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ-ja është shprehur se, megjithëse gjykatave u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përse u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t’u ankuar.¹³

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

Në të gjitha dokumentet ligjorë të analizuar, rezulton se arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material penal. Evidentohet kujdesi i shtuar i gjyqtarit në arsyetim për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore para zbatimit të tyre mbi faktet e provuara në gjykim.

Gjyqtari i kushton rëndësi analizës së instituteve të caktuara të së drejtës, kur kjo rezulton e nevojshme. Konkretisht konstatohet se gjyqtari:

- Analizon institutin juridik të parashkrimit fitues me titull. Në funksion të kësaj analize gjyqtari në mënyrë të detajuar jep përkufizimin e posedimit, mirëbesimit, afatit kohor brenda të cilit duhet shtrirë posedimi si dhe analizon çdo kriter juridik të domosdoshëm për të qenë përpara fitimit të pronësisë me parashkrim fitues pa titull.¹⁴

¹³ Vendimi i GjEDNJ, çështja Hadjanastassiou vs Greqisë, dt. 16.12.1992, fq. 33.

¹⁴ Vendim nr.137(49), datë 29.07.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë (me objekt njohje pronar).

- Analizon konceptet juridike të padisë rrethin e subjekteve që mund ti drejtohen gjykatës për rivendosjen e të drejtave të pretenduara si të shkelur, aktet e fitimit të pronësisë që duhen regjistruar, të drejtën e pronës, regjistrimin e pasurisë, mënyrat e regjistrimit fillestar etj. Në mënyrë të detajuar gjyqtari analizon parimet bazë të regjistrimit si regjim imponues, konkretisht parimin e deklarimit dhe parimin e prioritetit si dhe sistemet kryesore të regjistrimit (*sistemi i regjistrave të pronave ose i kadastrës si dhe sistemin e transkriptimit*)¹⁵.
- Analizon institutit e martesës, të drejtës për martesë si dhe zgjidhjes së martesës, duke dhënë përkufizimin e martesës si një bashkëjetesë ligjore, e cila mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok si baza e unitetit në familje. Analizon pasojat ligjore të zgjidhjes së martesës për ish-bashkëshortët, duke evidentuar kategoritë e pasojave duke i klasifikuar në pasoja të zgjidhjes së martesës mbi bashkëshortët dhe pasoja mbi fëmijët. Nga ana tjetër pasojat e zgjidhjes së martesës për bashkëshortët gjyqtari i klasifikon në pasoja me karakter personal dhe pasuror. Në këtë kontekst, gjyqtari aplikon mbi faktet e çështjes pasojat me karakter personal, lidhur me ndryshimin e mbiemrit.¹⁶
- Në kuadër të vlerësimit të elementëve thelbësorë të kërkesës, gjyqtari analizon pavlefshmërinë absolute dhe relative të akteve, të parashikuara në nenet 128 dhe 128/a të K.Pr.Penale duke bërë dhe dallimin mes tyre, duke evidentuar natyrën referuese të pavlefshmërisë relative si dhe duke listuar për çdo kategori pavlefshmërie rastet e tyre, të parashikuara si të tilla nga K.Pr.Penale.¹⁷
- Analizon natyrën juridike të nenit 32 të K.Pr.Civile si një dispozitë kuadër dhe të përgjithshme, e cila kategorizon proceduralisht llojet e padive. Në vijim, gjyqtari analizon natyrën juridike të kërtimeve të përfshira në nenin 32 të K.Pr.Civile. Në funksion të kësaj analize gjyqtari argumenton se në padinë sipas nenit 32/b të K.Pr.Civile konflikti lind nga kundërshtimet rreth ekzistencës ose mosekzistencës së marrëdhënies juridike ose një të drejte midis palëve ndërgjyqëse, ndërsa padinë sipas nenit 32/c konflikti nis për shkak të kundërshtimeve të vërtetësisë apo pavërtetësisë së dokumentit.¹⁸
- Analizon konceptet juridike të marrëdhënies së detyrimit, kontratës, provave, barrën e provave, duke bërë dhe kategorizimin e fakteve në fakte formuese (*konstitutive*), fakte penguese dhe fakte shuese. Në këtë kontekst, gjyqtari duke analizuar në tërësi legjislacionin procedural civil ka arsyetuar se barra e provës nuk mund të trajtohet si detyrë ekskluzive e palëve, sepse rolin aktiv në zbulimin e të vërtetës materiale gjykata mund ta luajë vetëm nëqoftëse ngarkohet me detyrën që saktësisht të vërtetojë gjendjen faktike, duke marrë edhe prova, të cilat nuk i kanë propozuar palët. Pra, detyrimi i palëve për të provuar faktet ku i mbështesin kërkimet apo prapësimet e tyre nuk e mënjanojnë kurrsesi gjykatën që të përcaktojë rrethin e atyre fakteve që përbëjnë objektin e provave, të ndihmojë palët në paraqitjen e provave dhe kur është e

¹⁵ Vendim nr.208 (338), datë 04.04.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër (*me objekt shfuqizim vendimi*).

¹⁶ Vendim nr.34, datë 13.05.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë (*me objekt zgjidhje martese*).

¹⁷ Vendim nr.40, datë 12.12.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë (*me objekt dërgimin në gjyq*).

¹⁸ Vendim nr.60, datë 05.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë (*me objekt njohje trashëgimtarë*).

nevojshme të investohet kryesisht kur konstaton se provat e propozuara nuk janë të mjaftueshme.¹⁹

- Analizon rolin e shqyrtimit të veprimtarisë administrative, qëllimin e legjislacionit tatimor, konceptin e buxhetit të shtetit, kundërvajtjet administrative në kuadër të kontrolleve tatimore, llojeve të tyre etj. Në vijim gjyqtari jep konceptet juridike të veprimit administrativ, të aktit administrativ duke u ndalur më tej te pavlefshmëria absolute dhe relative e tij.²⁰

Gjyqtari ka aftësi shumë të mira në paraqitjen dhe analizën e fakteve të çështjes, analizë e cila në vendimet e themelit është e detajuar dhe e plotë, duke integruar si pjesë të saj, provat mbi të cilat mbështetet konkluzioni i gjyqtarit për provueshmërinë e fakteve konkrete. Veç procesit analitik të provave, spikat aftësia e gjyqtarit në interpretimin dhe zërthimin e dispozitave ligjore të zbatueshme si dhe i praktikës gjyqësore. Por edhe pse analiza e detajuar e provave dhe interpretimi i ligjit është pjesë e rëndësishme e arsytimit të vendimit gjyqësor në tërësi, ajo nuk është e mjaftueshme për të gjykuar mbi cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik të gjyqtarit. Nëse ajo nuk shoqërohet me të njëjtën shkallë kujdesi me analizën se si konceptet ligjore dhe institutet lidhen midis tyre apo se si ato zbatohen në një situatë të caktuar (faktet e provuara), argumentimi logjik nuk është shterues. Në dokumentet ligjorë spikat aftësia e gjyqtarit në drejtim të analizës së provave dhe interpretimit të ligjit, madje të dy këta komponentë zënë peshën më të madhe të arsytimit të vendimeve, analizë që bazohet në arsye dhe logjikë. E njëjta rrjedhë logjike dhe cilësi analitike nuk spikat në çdo rast kur analizohet zbatimi i dispozitës mbi faktet e provuara, e cila është ajo që lidhet drejtpërdrejt me konkluzionin e arritur. Në vendimet gjyqësore nuk ka një ekuilibër midis pjesës përshkruese dhe asaj analitike, duke mos i dhënë më shumë rëndësi kësaj të fundit. Gjyqtari nuk është për të përshkruar, por për të analizuar dhe vlerësuar. Peshën më të madhe në vendim duhet ta zërë pikërisht komponenti analitik, prandaj sasia e arsytimit duhet të mbizotërohet nga pjesa analitike dhe argumentimi logjik se si dispozitat e interpretuara në mënyrë abstrakte dhe praktika gjyqësore zbatohet mbi faktet e provuara.

Nëse argumentimin logjik të analizës do ta ndanim në dy pjesë, në procesin analitik të të provuarit të fakteve dhe atë logjik se si konceptet, institutet dhe dispozitat ligjore zbatohen në një situatë të caktuar të provuar, i pari mbizotëron në analizën e gjyqtarit. Peshën kryesore në vendimet gjyqësore të analizuar e zë kryesisht procesi analitik i të provuarit të fakteve dhe ai i interpretimit abstrakt të normës materiale. E njëjta shkallë aftësie nuk evidentohet në analizën e zbatimit të ligjit mbi faktet e provuara. Kjo mënyrë e të shkruarit dhe të arsyetuarit, jo gjithmonë evidenton nëse faktet konkrete të çështjes janë të asaj natyre, cilësie (kualiteti) dhe të tilla çfarë kërkohet nga dispozitat e ligjit material apo atij procedural, në lidhje të drejtpërdrejtë me konkluzionin e arritur.

¹⁹ Vendim nr.60, datë 04.10.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë (me objekt përmbushje detyrimi kontraktor).

²⁰ Vendim nr.302 (447), datë 09.05.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër (me objekt pavlefshmërinë e aktit administrativ).

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, në të gjitha vendimet burim vlerësimi ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar në atë pjesë të arsyetimit me të cilën lidhet pretendimi (me aspektet procedurale të gjykimit, marrjen e provave dhe mënyrën e marrjes së tyre, provueshmërinë e faktit, cilësimin ligjor të faktit penal apo përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes civile, administrative, etj.) apo janë pjesë e analizës ligjore, duke u identifikuar në mënyrë të veçantë në pjesën arsyetuese të vendimit.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, Këshilli pasi vlerësoi edhe kundërshtimet e gjyqtarit në lidhje me këtë tregues, konkludoi se referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi “Mbi mesataren” në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Edhe pse cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim ligjor-konkluzion, nuk reflektohet e njëjta shkallë kujdesi në lidhje me argumentimin logjik se si dispozitat ligjore zbatohen mbi faktet e provuara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Në tërësi, referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “Mbi mesataren” duke e pikëzuar me 20 pikë. Ky konkluzion bazohet në analizën e metodologjisë së përgjithshme të punës së gjyqtarit në drejtim të këtij treguesi, duke analizuar të gjitha llojet e çështjeve të përzgjedhura, pa i dhënë peshë dhe rëndësi të veçantë asnjërës prej tyre.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
87	Shumë mirë

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit viti 2022, rezulton se:

Në total gjyqtari *për vitin 2022* sipas statistikave të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë ka gjykuar 32 çështje,²¹ për të cilat ligji parashikon afat ligjor (*nga të cilat 11 prej tyre janë gjykuar jashtë afatit ligjor*)²² dhe 110 çështje me afat standard minimal. Sa më sipër, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (*gjithsej 11 çështje*), me numrin e çështjeve të gjykuara, për të cilat ligji parashikon këtë afat ligjor (32 çështje), gjyqtari {...} rezulton që të ketë gjykuar 34% të çështjeve me afat ligjor jashtë këtij afati.

Në total gjyqtari *për vitin 2022*, referuar statistikave të ardhura nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ka gjykuar 4 çështje,²³ për të cilat ligji parashikon afat ligjor dhe 99 çështje me afat standard minimal. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (*gjithsej 4 çështje*), me numrin e çështjeve të gjykuara, për të cilat ligji parashikon këtë afat ligjor (4 çështje), gjyqtari referuar statistikave të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër rezulton që të ketë gjykuar 100% të çështjeve me afat ligjor jashtë këtij afati.

Në analizë tërësore të të dhënave statistikore për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, rezulton se gjyqtari subjekt vlerësimi ka gjykuar në total 36 çështje për të cilat ligji ka parashikuar afate gjykimi (32 të gjykuara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe 4 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër), nga të cilat 15 janë gjykuar jashtë këtij afati. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (*gjithsej 15 çështje*), me numrin e çështjeve të gjykuara, për të cilat ligji parashikon këtë afat ligjor (36 çështje), gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar 41.6% të çështjeve me afat ligjor jashtë këtij afati.

Në Formularët e Integruar të Vlerësimit (referuar të dhënave statistikore për çështjet e gjykuara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër) gjyqtari ka analizuar të dhënat statistikore dhe ka arritur në përfundimin se kryesisht duke iu referuar afatit të arsyeshëm të gjykimit (*neni 399/2 të K.Pr.Civile*) ka gjykuar 6.04 % të çështjeve të gjykuara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë jashtë afatit dhe 20% të çështjeve të gjykuara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër jashtë afatit ligjor, të parashikuar në ligj.

²¹ Tabela nr.2, çështja me numër rendor 6; Tabela nr.3, çështjet me numër rendor 14, 15; Tabela nr.10 çështjet me numër rendor 1-20; Tabela me nr.11 çështjet me numër rendor 1, 3, 6, 12, 14, 16, 18-20.

²² Tabela nr.2, çështja me numër rendor 6; Tabela nr.3, çështja me numër rendor 14; Tabela nr.10 çështjet me numër rendor 3, 15, 19; Tabela nr.11 çështjet me numër rendor 1, 3, 6, 12, 14, 16.

²³ Tabela nr.1, çështjet me numër rendor 4, 18; Tabela nr.2, çështjet me numër rendor 20, 22;

Në detyrën e vlerësuesit është bërja e analizës së të dhënave statistikore në mënyrë të tillë që të shmangen përfundime që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Për analizën e këtij treguesi, vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhënat statistikore, por merr në konsideratë të gjitha të dhënat e burimeve të tjera të vlerësimit.

Përqindja e mësipërme 41.6 % e çështjeve jashtë afatit ligjor sipas Metodologjisë pikëzohet me 3 (tre) pikë. Në Metodologji, lidhur me këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjitha burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore, për 15 çështjet e shqyrtuara jashtë afateve ligjore, evidentohet se në disa raste vonesat kanë qenë të papërfillshme ose është ndikuar nga procesi administrativ i mbartjeve të dosjeve në fund të vitit. Konkretisht:

- Për çështjet me objekt *“Caktim përfaqësuesi”*,²⁴ rezulton se gjykimi për këtë çështje është tejkalluar vetëm në 1 ditë, tejkallim i cili vlerësohet i pakonsiderueshëm dhe si i tillë kjo çështje do të konsiderohet e shqyrtuar brenda afatit ligjor. Gjithashtu, për 1 çështje me objekt *“Lëshimin e urdhrin të mbrojtjes”* gjykimi është tejkalluar afati vetëm me 3 ditë.²⁵ Gjithashtu, edhe për dy çështje të pasqyruara në tabelën nr. 10 me objekt *“Shuarje mase”* dhe *“Zëvendësim mase”* rezulton se afati i gjykimit është tejkalluar përkatësisht me 1 dhe me 3 ditë.²⁶ Në tabelën nr.2 të kategorisë *“Administrative pa palë”* në çështjen me objekt *“Sigurim padie”* rezulton se tejkallimi i afatit është me vetëm 3 ditë.²⁷ Sa më sipër, duke qenë se tejkallimi i afateve në çështjet e mësipërme është i pakonsiderueshëm, këto çështje do të konsiderohen si të gjykuara brenda afateve ligjore të përcaktuara në ligj.
- Gjithashtu, për 1 çështje gjykimi me objekt *“Kundërshtim veprimesh përmbartimore”*²⁸ është tejkalluar për 22 ditë dhe nga të dhënat statistikore, rezulton që është hedhur në short në datë 16.12.2021 dhe është përfunduar në datë 26.01.2022, pra gjatë periudhës së fundvitit, e cila përkon dhe me procesin e mbartjes së dosjeve nga administrata gjyqësore dhe do të konsiderohet brenda afatit ligjor.

Nga një rillogaritje matematikore e përqindjes së çështjeve të shqyrtuara tej afateve ligjore, duke zbritur nga totali prej 15 çështje, 6 çështjet e mësipërme të cilat duhet të konsiderohen në afat, pasi tejkallimi i afatit ka qenë i papërfillshëm, rezulton se kjo përqindje është 25% (9 çështje nga 36 çështje të shqyrtuara tej afatit), përqindje e cila sipas metodologjisë përkon me nivelin e vlerësimit prej 9 (nëntë) pikësh.

²⁴ Çështja me nr. 6 rendor, nga Tabela Nr. 2, e dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë.

²⁵ Çështja me nr. 14 rendor, nga Tabela Nr. 3, e dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë.

²⁶ Çështjet me nr. 3 dhe 5 rendor, nga Tabela Nr. 10, e dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë.

²⁷ Çështja me nr. 20 rendor, nga Tabela Nr. 2, e dërguar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër.

²⁸ Çështja me nr.4, nga Tabela Nr. 1, e dërguar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër.

Kryetarja në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë në mendimin e saj e ka vlerësuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të këtij treguesi si “shumë të lartë”, ndërsa ajo e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër e ka konsideruar si “mbi mesatare”, duke u shprehur se gjyqtari ka gjykuar 21 çështje tej afatit të arsyeshëm 1/vjeçar dhe 82 brenda këtij afati, pa bërë ndarje të çështjeve me afat ligjor nga ato me standard minimal.

Lidhur me këtë tregues gjyqtari, ka paraqitur kundërshtime, duke parashtruar se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, gjatë periudhës së vlerësimit, nga data 01.01.2022-31.12.2022, ka gjykuar gjithsej 149 çështje, duke analizuar se çështjet e kategorive i) civile me palë kundërshtare; ii) civile pa palë kundërshtar; iii) familjare me palë kundërshtare; iv) familjare pa palë kundërshtare; v) marrëdhënie pune vi) penale krime dhe vii) penale kundërvajtje, janë gjykuar brenda afatit të arsyeshëm ligjor 2 vjeçar të parashikuar nga neni 399/2 pika 1 të Kodit të Procedurës Civile, apo 1 vjeçar në rastin e kundërvajtjeve. Po kështu, gjyqtari parashtron se ka gjykuar:

- vetëm 1 çështje tej afatit të posaçëm ligjor të parashikuar nga Kodi i Procedurës Penale për zëvendësimin e masës së sigurimit: çështja penale nr. A/28 e regjistruar më datë 08.11.2022, shpallur vendimi më datë 16.11.2022, pra për 8 ditë, 3 ditë tej afatit të posaçëm ligjor 5 ditor;
- në çështjet me objekt “Dërgim në gjyq” 6 prej tyre janë përfunduar tej afatit të posaçëm ligjor 30 ditor, kurse 3 të tjerat janë përfunduar brenda afatit 30 ditor
- në çështjet me objekt “Mosfillim procedimi penal”, njëra prej çështjeve është tej afatit 30 ditor;
- çështja me objekt kundërshtim vendimi të Prokurorisë: është shortuar më datë 17.10.2022 dhe ka përfunduar më datë 25.03.2022, tej afatit të posaçëm ligjor 15 ditor.

Duke arritur në përfundimin se nga 149 çështje të shqyrtuara, 9 prej tyre janë gjykuar tej afateve të posaçme apo të përgjithshme të parashikuara nga kodet respektive, në përqindje 6,04 % tej afateve të arsyeshme ligjore.

Gjithashtu, referuar të dhënat statistikore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, gjatë periudhës së vlerësimit, nga data 01.01.2022-31.05.2022, ka gjykuar gjithsej 103 çështje, ku duke i i përmbledhur, rezultojnë këto të dhëna:

- a) 21 çështje tej afatit të arsyeshëm ligjor 1 vjeçar.
- b) 82 çështje brenda afatit të arsyeshëm ligjor 1 vjeçar.

Duke i përmbledhur në përqindje, 21 çështje tej afatit të arsyeshëm ligjor përbëjnë **20%** të të gjitha çështjeve.

Në përfundim lidhur me këtë tregues gjyqtari kërkon vlerësimin maksimal pasi: i) Periudha e ushtrimit të funksionit të gjyqtarit për vitin 2022 është më e gjatë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë se sa në Gjykatën Administrative Shkalla e Parë Shkodër. Kështu gjatë vitit 2022, janë 5 muaj në detyrë në gjykatën administrative dhe 12 muaj në gjykatën e rrethit. Ushtrimi i njëkohshëm i detyrës së gjyqtarit në dy gjykata (Maj 2021-31 Maj 2022) ka krijuar vështirësi të mëdha për përballimin e ngarkesës në punë, duke sjell në vëmendjen se është me vendbanim në Lezhë dhe duhej të shkonte në Pukë dhe në Shkodër. ii) Ka patur shumë ditë përgjatë pesëmuajorit të parë të vitit 2022 që në të njëjtën ditë ka gjykuar njëkohësisht në dy gjykata, edhe në Gjykatën Administrative Shkodër edhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, ku ishte i detyruar për të

shkuar në këtë të fundit për të shqyrtuar kërkesat e ngutshme si vleftësimit e arresteve; lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes; lejim përgjimi, etj kërkesa me natyra të ngutshme, përveç seancave të planifikuara. iii) Terreni i vështirë malor për të shkuar në selinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe kushtet e vështira klimaterike gjatë periudhës së dimrit, duke filluar nga muaji Nëntor deri në muajin Mars, Prill të vitit pasardhës...

KONKLUZIONE:

Duke iu referuar analizës logjike të të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, konkretisht:

- a) numrit të ulët të çështjeve të shqyrtuara, të cilat llogariten me afat ligjor (36 çështje), çka sjell përqindje të lartë të raportit të çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor me numrin e çështjeve për të cilat ligji parashikon afat ligjor;
- b) pamundësinë e respektimit në të gjitha rastet të afatit ligjor 20/ditor sipas nenit 610 të K.Pr.Civile, për shkak të veprimeve procedurale të nevojshme për t'u kryer në kuadër të gjykimit administrativ, me qëllim respektimin e të drejtave dhe detyrave procedurale të organit publik (*personit fizik apo juridik që ofron një shërbim publik*);
- c) faktit që gjatë pesëmuajorit të parë të periudhës së vlerësimit (01.01.2022-31.12.2022) gjyqtari ka ushtruar njëkohësisht detyrën në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë,

për këtë tregues, gjyqtari pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi se ai që i përket përqindjes së çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit, pavarësisht se përqindja e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor rezulton 25%. Por gjyqtari megjithë kundërshtimet e tij, nuk mund të pikëzohet maksimalisht, pasi pavarësisht ekzistencës së rrethanave objektive të pasqyruara nga ana e gjyqtarit, ai duhet t'i kishte kushtuar një rëndësi të veçantë dhe parësore çështjeve me afat ligjor, të cilat për shkak të rëndësisë së tyre duhet të gjykohen jo brenda afateve të arsyeshme, por brenda afateve të përcaktuara shprehimisht nga ligji procedural përkatës. Pavarësisht rrethanave konkrete që lidhen me kushtet e punës, numri relativisht i vogël i çështjeve me afat gjykimi (në total 36 nga të cilat 9 jashtë afatit) nuk justifikon një pikëzim maksimal, sepse gjyqtari duhej të kishte treguar një shkallë më të lartë kujdesi në shqyrtimin me përparësi të këtyre çështjeve. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, respektimit i afateve ligjore nënkupton respektimin nga ana e gjyqtarit të afateve të parashikuara në ligj brenda të cilave duhet të përfundojë gjykimi i një çështje. Neni 399/2 i K.Pr.Civile, i referuar nga gjyqtari si përcaktim i afatit brenda të cilit duhet të shqyrtohet çështja, nuk është relevant, pasi kjo dispozitë procedurale parashikon mjetet juridike për t'u mbrojtur nga cenimi i së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm dhe nuk lidhet me afatet ligjore të përcaktuara në ligj, brenda të cilit duhet të përfundojë çështja.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar përqindjes së çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor dhe shkallës së përgjegjësisë së gjyqtarit, në lidhje me këtë tregues gjyqtari pikëzohet me 12 pikë.*

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka ushtruar funksionin e tij në dy gjykata, përkatësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Për periudhën që ka ushtruar funksionin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, analiza e të dhënave statistikore për këtë tregues, do të bëhet duke iu referuar Vendimit të ish-KLD nr. 261/2, datë 14.04.2010. Për periudhën që ka ushtruar funksionin pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, analiza e të dhënave në lidhje me këtë tregues, do të bëhet duke iu referuar Vendimit të ish-KLD nr. 261/2, datë 14.04.2010 dhe ligjit nr.49/2012. Konkretisht rezultojnë të dhënat si më poshtë vijon:

Në Gjykatën e Shkallës së Parë Pukë gjyqtari për vitin 2022 ka gjykuar në total 110 çështje me afat standard minimal, nga të cilat 36²⁹ prej tyre janë shqyrtuar jashtë afatit standard minimal. Sa më sipër, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit standard minimal (*gjithsej 36 çështje*), me numrin e çështjeve të gjykuara, për të cilat ligji parashikon këtë afat (*110 çështje*), gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar 32.7% të çështjeve jashtë afatit standard minimal.

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër rezulton se gjyqtari ka gjykuar 99 çështje me afat standard minimal. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit standard minimal (*gjithsej 96 çështje*), me numrin e çështjeve të gjykuara, për të cilat ligji parashikon këtë afat (*99 çështje*), gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar 96.9% të çështjeve janë gjykuar afatit standard minimal.

Duke iu referuar parashikimeve të nenit 25 të ligjit nr.49/2012, në të cilin parashikohet afati 7 ditor për kryerjen e veprimeve paraprake, afatit maksimal 10 ditor për plotësimin e të metave të padisë për paditësin, afatit maksimal 10 ditor për depozitim të prapësimeve me shkrim dhe provave nga pala e paditur, afatit maksimal 20 ditor për kryerjen e ekspertimit në rast se vlerësohet i nevojshëm, afatit minimal 5 ditor për njoftimin e palëve për kryerjen e veprimeve si më sipër, rezulton se veprimet përgatitore që duhet të kryejë gjyqtari në një çështje administrative me palë zgjatën mesatarisht 47 ditë.

Nëse do të zhvillohet seancë përgatitore për të qartësuar natyrën e mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 158/b të Kodit të Procedurës Civile, pas përfundimit të veprimeve përgatitore sipas nenit 25 të ligjit nr.49/2012, bashkë me kohën minimale të nevojshme për realizimin e njoftimeve të palëve, kjo fazë e gjykimit zgjat 15 ditë.

²⁹Tabela nr.1, çështjet me numër rendor 1-7, 9-11, 18; Tabela nr.2, çështjet me numër rendor 1, 3, 7, 8; Tabela nr.3, çështjet me numër rendor 1-6, 8, 11; Tabela nr.4, çështjet me numër rendor 2, 3, 5; Tabela nr.8, çështje me numër rendor 1, 2; Tabela nr.11, çështja me numër rendor 2, 4, 13; Tabela nr.12, çështjet me numër rendor 1-3, 7, 8.

Pas zhvillimit të seancës përgatitore, caktimi i seancës gjyqësore, në referim të nenit 27 pika 1 të ligjit nr. 49/2012, duhet të jetë brenda afatit ligjor 15 ditor. Në rast se procesi gjyqësor do të zhvillohet brenda një seance gjyqësore dhe nuk do të ketë kërkesa të palëve për shtyrje të gjykimit, kryerjen e veprimeve të tjera procedurale që do të pasjellin shtyrje të seancës, duke marrë parasysh vetëm afatin 5 ditor të parashikuar nga neni 302 i K.Pr.Civile për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare të palëve, dhe afatin 5 ditor të parashikuar nga neni 308 të K.Pr.Civile për shpalljen e vendimit të arsyetuar nga gjykata, kohëzgjatja e gjykimit nga momenti i përfundimit të seancës përgatitore deri në shpalljen e vendimit do të ishte minimalisht 25 ditë.

Në tërësi, duke iu referuar afateve për zhvillimin e veprimeve procedurale si më sipër, **gjykimi i një çështje administrative do të përfundonte brenda një afati minimal prej 87 ditësh.** Ky afat minimal kohor për përfundimin e gjykimit të çështjes administrative, duke respektuar të gjitha hapat proceduralë të domosdoshëm për zhvillimit e gjykimit si dhe duke respektuar me rigorozitet afatet procedurale për kryerjen e tyre, është dukshëm më i gjatë se standardi minimal kohor orientues në fuqi.

Respektimi strikt i afateve të parashikuara nga ligji nr.49/2012 dhe Kodi i Procedurës Civile, sjell një kohëzgjatje gjykimi të çështjeve më shumë se 1 (një) muaj nga ajo e përcaktuar si standard orientues në bazë të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të ish-KLD, e si i tillë ky i fundit nuk ka kuptim të gjejë zbatim.

Në lidhje me çështjet e gjykuara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, sipas Raportit Analitik, rezultojnë se:

- Në bazë të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të ish-KLD, i cili ka parashikuar afatin orientues një muaj për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, konstatohet se gjyqtari subjekt vlerësimi ka gjykuar 96 çështje jashtë këtij afati, nga 99 çështje të gjykuara në total.
- Në bazë të afatit 87 ditë të ligjit nr. 49/2012 i ndryshuar, gjyqtari ka gjykuar në total 99 çështje, prej të cilave 72 jashtë afatit.

Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të këtij afati 87 ditësh (gjithsej 72 çështje), me numrin e çështjeve të llogaritura me afat standard minimal (99 çështje), gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar 72.7% të çështjeve jashtë afatit 87 ditësh për gjykimin administrativ.

Në analizë tërësore të të dhënave statistikore për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, rezultojnë se gjyqtari ka gjykuar në total 209 çështje për të cilat ligji nuk ka parashikuar afate gjykimi, por afate standarde gjykimi (110 të gjykuara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe 99 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër), nga të cilat 132 janë gjykuar jashtë këtij afati. **Sa më sipër, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të afatit standard minimal për çështjet e gjykuara në të dyja gjykatat (gjithsej 132 çështje), me numrin e çështjeve të gjykuara, për të cilat ligji parashikon këtë afat (209**

çështje), gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar 63.1% të çështjeve janë gjykuar afatit standard minimal.

Në Formularët e Integruar të Vlerësimit përkatësisht për çështjet e gjykuara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër gjyqtari ka analizuar të dhënat statistikore dhe ka theksuar gjatë vitit 2022, ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, njëkohësisht në dy gjykata. Gjyqtari ka evidentuar se në ditë të ndryshme të vitit ka gjykuar brenda ditës edhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë edhe në Gjykatën Administrative Shkalla e Parë Shkodër. Gjithashtu gjyqtari subjekt vlerësimi ka sjellë në vëmendje largësinë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë përkundrejt Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, duke i shtuar kësaj largësie edhe terrenin e vështirë malor.

Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, për 132 çështjet e shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, rezulton se në disa raste vonesa në shqyrtim ka ardhur si pasojë e lejes vjetore të kryer nga gjyqtari në muajin gusht (35 ditë). Nëse në përllogaritjen e afatit të gjykimit nuk do të përfshihej periudha kur gjyqtari ka qenë me leje vjetore, atëherë disa prej këtyre çështjeve do të kishin përfunduar brenda standardeve minimale kohor. Konkretisht:

- Për kategorinë “Civile me palë kundërshtare”, rezulton se çështja me numër rendor 6, i është caktuar gjyqtarit me short në datën 26.07.2021 dhe ka përfunduar në datën 09.02.2022 (198 ditë). Duke hequr periudhën e lejes vjetore në vitin 2021 (35 ditë), kjo çështje do të kishte përfunduar për 163 ditë, pra brenda standardit minimal kohor 6 muaj (180 ditë) për gjykimin e çështjeve civile me palë kundërshtare. Në këtë kategori çështjesh rezultojnë edhe çështja me numër rendor 10, e cila ka përfunduar për 185 ditë, duke tejkaluar me vetëm 5 ditë afatin standard prej 6 muaj ose 180 ditë;
- Për kategorinë “Civile pa palë kundërshtare”, rezulton se çështja me numër rendor 7, i është caktuar gjyqtarit me short në datën 21.07.2022 dhe ka përfunduar në datën 18.10.2022 (89 ditë). Duke hequr periudhën e lejes vjetore në vitin 2022 (35 ditë), kjo çështje do të kishte përfunduar për 54 ditë, pra brenda standardit minimal kohor 2 muaj (60 ditë) për gjykimin e çështjeve civile pa palë kundërshtare. Në këtë kategori çështjesh rezultojnë edhe çështja me numër rendor 8, e cila ka përfunduar për 69 ditë, duke tejkaluar me vetëm 9 ditë afatin standard prej 2 muaj ose 60 ditë;
- Për kategorinë “Penale, seancë paraprake”, rezulton se çështja me numër rendor 4 me objekt “Kërkesë për pushimin e procedimit penal”, ka përfunduar për 68 ditë, duke tejkaluar me vetëm 8 ditë afatin standard prej 2 muaj ose 60 ditë; çështja me numër rendor 13, i është caktuar gjyqtarit me short në datën 18.07.2022 dhe ka përfunduar në datën 11.10.2022, duke përfunduar për 85 ditë. Duke zbritur periudhën e lejes vjetore në vitin 2022 (35 ditë), kjo çështje do të kishte përfunduar për 50 ditë, pra brenda standardit minimal kohor 2 muaj ose 60 ditë;

Nëse në përllogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, do të përjashtoheshin 6 çështjet e analizuar më sipër, të cilat, nëse do të zbritet periudha e lejes

vjetore, rezultojnë të përfunduara brenda afatit apo ky afat rezulton i tejkaluar me vetëm 5 deri në 9 ditë, rezulton se nga 209 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 126 prej tyre ose rreth 60.2% janë gjykuar jashtë standardit minimal kohor në fuqi, i cili sipas Metodologjisë pikëzohet me 1 pikë. Referuar përsëri të njëjtit akt nënligjor, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në pikëzim maksimal, duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me produktivitetin e gjyqtarit.³⁰

Kryetarja në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe ajo e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër në mendimin e tyre, bazuar në të njëjtat të dhëna statistikore, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të këtij treguesi si “mesatare”.

Lidhur me këtë tregues gjyqtari, ka paraqitur kundërshtime, duke parashtruar se *vlerësimi për vitin 2022 përbën një vlerësim të një viti të veçantë, por duhet të mbahet në konsideratë edhe ngarkesa paraardhëse, pra, nuk mund të shihet si i shkëputur. Konkretisht më datë 14 Maj 2021 janë shortuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe sipas shortit i kanë kaluar për gjykim rreth 60 çështje, përveç shorteve periodike. Gjithashtu, çështje të mbartura për vitin 2022 në Gjykatën Administrative Shkodër kanë qenë gjithsej 214. Prandaj, duke marrë në konsideratë periudhën e punës më të gjatë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë se sa në Gjykatën Administrative Shkodër, dhe në lidhje me plotësimin e standardeve minimale kohore gjyqtari vlerëson se duhet të vlerësohet në nivelin “Mesatare”.*

Bashkëlidhur kundërshtimeve gjyqtari ka paraqitur edhe listën e shortit për periudhën maj-dhjetor 2021, listën e rishortimeve të datës 14.05.2021, ngarkesën e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, për vitin 2021, si dhe njoftimit/lajmërimet mbi kohën e keqe në qytetin e Pukës (në datat 21.01.2022, 29.01.2022, 08.02.2022, 27.02.2022, 27.09.2022). Po kështu, nëpërmjet postes elektronike në datën 12.07.2023 ka paraqitur raportin mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë nga data 7-21 janar 2022, vërtetim për kryerjen e lejes vjetor të vitit 2021, në periudhën 20.12.2021-14.01.2022.

Pas analizës të provave të paraqitura nga gjyqtari, periudha gjatë të cilës gjyqtari ka qenë me raport për paaftësi të përkohshme në punë (21 ditë), ka ndikuar vetëm në një prej çështjeve. Konkretisht: në kategorinë “Civile me palë kundërshtare”, çështja me numër rendor 9, i është caktuar gjyqtarit me short në datën 13.09.2021 dhe ka përfunduar në datën 01.04.2022 (200 ditë). Duke hequr periudhën në të cilin gjyqtari ka qenë me raport (21 ditë), kjo çështje do të kishte përfunduar për 179 ditë, pra brenda standardit minimal kohor 6 muaj (180 ditë) për gjykimin e çështjeve civile me palë kundërshtare.

³⁰ Në Metodologjinë e Pikëzimit, sa i përket këtij treguesi, parashikohet se:” *Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal.”.*

Nga ana tjetër, lidhur me ditët në të cilat gjyqtari ka qenë në pamundësi për të shkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë për shkak të motit të keq (gjithsej 5 ditë), evidentohet se në asnjë prej çështjet të analizuara nuk rezultoi që këto ditë të kenë ndikuar në standardin minimal kohor, pasi tejkalimi i tij në disa raste shkon deri në 335 ditë.

Pra, edhe nëse në përllogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, do të përjashtoheshin çështjet e analizuar më sipër, rezultoi se nga 209 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 125 prej tyre ose rreth 59.8% janë gjykuar jashtë standardit minimal kohor në fuqi, i cili sipas Metodologjisë pikëzohet me 1 pikë.

KONKLUZIONE:

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me :

- a) afatin e gjykimit të çështjeve administrative për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, duke pranuar si të tillë atë 87/ditor dhe jo 1/mujor;
- b) raportit të çështjeve të gjykuara tej afatit standard, me numrin total të çështjeve për të cilat zbatohet ky afat, i cili rezultoi të jetë në masën 60.2%;
- c) shkaqet që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit sikurse është fakti që gjyqtari *ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, njëkohësisht në dy gjykata. Gjyqtari ka evidentuar se në ditët të ndryshme të vitit ka gjykuar brenda ditës edhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë edhe në Gjykatën Administrative Shkalla e Parë Shkodër*;
- d) mendimin e dy kryetarëve të gjykatave respektive ku gjyqtari ka ushtruar detyrën të cilët e vlerësojnë shkallën e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues si “mesatare”, e njëjtë kjo me shkallën e aftësisë që dhe vetë gjyqtari ka vetvlerësuar veten e tij;
- e) natyrën orjentuese dhe jo detyruese të këtyre standardeve kohore, ku hapësira e vlerësuesit është me e gjerë se treguesi i “Respektimit të afateve ligjore”,

pavarësisht përqindjes së mësipërme, për këtë tregues gjyqtari pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi, me 2 pikë. Ngarkesa totale e punës së gjyqtarit, pavarësisht se për 5/muajt e parë të vitit 2022 ai me vullnetin e tij është caktuar për të gjykuar në dy gjykatat si më sipër, nuk justifikon zbatimin e një shkalle më të lartë pikëzimi në rastin konkret, pasi në total në të dyja gjykatat, gjyqtari ka gjykuar vetëm 245 çështje nga të cilat çështje me palë kundërshtarë janë vetëm 145 çështje, nën standardin sasior prej 200 çështjesh themeli.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Plotësimi i standardeve minimale kohore” gjyqtari pikëzohet me 2 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në raportin analitik, rezultojnë se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjyqimi, është më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve.

Konkretisht, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje për kategori, rezultojnë si më poshtë:

- Në kategorinë e çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 223 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj;
- Në kategorinë e çështjeve “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 33.6 ditë, pra më e shkurtër se afati standard minimal kohor i miratuar prej 2 muaj;
- Në kategorinë e çështjeve “Familjare me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 209 ditë, pra më e gjatë, se afati standard minimal kohor i miratuar prej 4 muaj;
- Në kategorinë e çështjeve “Familjare pa palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 61 ditë, pra e barabartë me afatin standard minimal kohor i miratuar prej 2 muaj, në kushtet kur ky afat tejkalohet me vetëm 1 ditë, tejkallim i cili konsiderohet i papërfillshëm duke pasur parasysh këtu edhe ditët e pushimit javor;
- Në kategorinë e çështjeve “Marrëdhënie pune”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 77.5 ditë, pra më e shkurtër se afati standard minimal kohor i miratuar prej 6 (gjashtë) muaj;
- Në kategorinë e çështjeve “Penale krime”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 146.3 ditë, pra më e shkurtër se afati standard minimal kohor i miratuar prej 9 apo 12 muaj;
- Në kategorinë e çështjeve “Kundërvajtje penale”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 71 ditë, pra më e shkurtër se afati standard minimal kohor i miratuar prej 4 muaj;
- Në kategorinë e çështjeve “Seancë paraprake-pushim çështje”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 39.3 ditë, pra më e shkurtër se afati standard minimal kohor i miratuar prej 2 muaj;
- Në kategorinë e çështjeve “Kërkesa në fazën e ekzekutimit dhe marrëdhënie juridiksionale me jashtë”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 90.3 ditë, pra më e gjatë se afati standard minimal kohor i miratuar prej 2 (dy) muaj;
- Në kategorinë e çështjeve “Administrative me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 324 ditë, pra më gjatë se standardi minimal kohor i miratuar prej 78 ditësh, referuar arsytimit të bërë më sipër në treguesin 2.A.b.;
- Në kategorinë e çështjeve “Administrative pa palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 68.4 ditë, pra më i gjatë se standardi minimal kohor i miratuar prej 30 ditësh sipas Vendimit të ish KLD-së nr.261/2, datë 14.04.2010;
- Në kategorinë e çështjeve “Marrëdhënie pune”, koha mesatare që i dedikohet çdo

çështje është 239 ditë , pra më e gjatë se standardi minimal kohor prej 78 ditësh.

Duke u bazuar vetëm në analizën matematikore të të dhënave, rezulton se nga 12 kategori çështjesh, për 6 prej tyre koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër ose e barabartë me standardin minimal kohor.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari nuk ka dhënë shpjegime konkrete lidhur me shkaqet e kohëzgjatjes së gjykimeve për kategoritë e çështjeve të gjykuara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, por e ka vlerësuar aftësinë e tij si “mbi mesataren” për detyrën e ushtruar në të dyja gjykatat (më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve). Ndërsa të dy kryetarët e gjykatave respektive, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të këtij treguesi në nivelin “ mbi mesataren” kryetari në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe “nën mesataren” kryetari në detyrë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se për të bërë pikëzimin e këtij treguesi, të dhënat statistikore analizohen sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.³¹ Referuar metodologjisë, duke qenë se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjes gjyqtari duhet të pikëzohet me 3 pikë. Por vlerësuesi merr parasysh në pikëzim situatën konkrete, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, si dhe krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje për të gjitha kategoritë, me standardin minimal kohor në fuqi për kategori çështjesh, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është e barabartë ose më e shkurtër se ky afat për 6 nga 12 kategoritë e çështjeve. Koha mesatare është më e gjatë se standardi për 6 nga kategoritë e çështjeve, përkatësisht:

- çështjet e kategorisë “Civile me palë kundërshtare”, duke u tejkalluar afati me 43 ditë;
- çështjet e kategorisë “Familjare me palë kundërshtare”, duke u tejkalluar afati 49 ditë;
- çështjet e kategorisë “Kërkesa në fazën e ekzekutimit dhe marrëdhënie juridiksionale me jashtë”, duke u tejkalluar afati me 30.3 ditë;
- çështjet e kategorisë “Administrative me palë kundërshtare”, duke u tejkalluar afati me 237 ditë;
- çështjet e kategorisë “Administrative pa palë kundërshtare”, duke u tejkalluar afati me 38.4 ditë;
- çështjet e kategorisë “Marrëdhënie pune”, duke u tejkalluar afati me 152 ditë.

KONKLUZIONE:

³¹Metodologjia e Pikëzimit për ketë tregues parashikon se :“... Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal.”.

Duke iu referuar analizës matematikore dhe logjike të të dhënave statistikore, rezulton se për këtë tregues gjyqtari pikëzohet me 3 pikë, pasi koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është “Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve”. Pavarësisht argumenteve të përdorura në analizën logjike të të dhënave statistikore për treguesin e “Plotësimin të standardeve minimale kohore”, gjyqtari nuk mund të pikëzohet me një nivel më të lartë, për shkak se ngarkesa e punës dhe tejkalimi me 237 ditë i standardit minimal kohor për çështjet e kategorisë “Administrative me palë kundërshtare” nuk justifikon rritjen e shkallës së pikëzimit.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, rezulton më e shkurtër se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve dhe analiza logjike e të dhënave statistikore nuk justifikon zbatimin e një shkalle më të lartë pikëzimi. Prandaj për këtë tregues gjyqtari pikëzohet me 3 (tre) pikë.*

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezultojnë të dhënat si më poshtë vijojnë:

Në vitin 2022 gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë rezulton se i janë caktuar 145 çështje dhe referuar të dhënave statistikore rezulton se për vitin 2022 në këtë gjykatë gjyqtari ka përfunduar 142 çështje. Në total duke iu referuar raportit të numrit të çështjeve gjyqësore të përfunduara nga gjyqtari për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë pavarësisht kohës së caktimit të tyre (142 çështje) me numrin e çështjeve gjyqësore që i janë caktuar gjatë kësaj periudhë (145), rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore në total është 97.9%.

Referuar të dhënave statistikore të dërguara nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, rezulton se rendimenti i subjektit të vlerësimit është si më poshtë vijon:

Në vitin 2022 gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër rezulton se i janë caktuar 93 çështje dhe referuar të dhënave statistikore rezulton se për vitin 2022 në këtë gjykatë gjyqtari ka përfunduar 103 çështje. Në total duke iu referuar raportit të numrit të çështjeve gjyqësore të përfunduara nga gjyqtari për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër pavarësisht kohës së caktimit të tyre (103 çështje) me numrin e çështjeve gjyqësore që i janë caktuar gjatë kësaj periudhë (93), rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore në total është 110.7%.

Në total në të dyja gjykatat (në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër) gjyqtarit i janë caktuar 238 çështje dhe ka përfunduar në të dyja

gjykatat 245 çështje. Në total duke iu referuar raportit të numrit të çështjeve gjyqësore të përfunduara nga gjyqtari për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër pavarësisht kohës së caktimit të tyre (245 çështje) me numrin e çështjeve gjyqësore që i janë caktuar gjatë kësaj periudhë (238), rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore në total është 102.9 %.

Në Formuarin e Vlerësimit gjyqtari e ka vlerësuar treguesin në nivelin “Shumë i lartë”. Kryetarët respektivë të gjykatave ku ka gjyqtari ka ushtruar funksionet në periudhën e vlerësimit e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtarit në këtë tregues në nivelin “Shumë e lartë”.

KONKLUSIONE:

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues gjyqtari pikëzohet me 10 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues gjyqtari pikëzohet me 10 pikë, pasi rendimenti rezulton në masën 102.9 %.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh, krahasuar me afatin procedural është si më poshtë:

- Për çështje të kategorisë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare e arsytimit është 6.1 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.
- Për çështje të kategorisë “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, koha mesatare e arsytimit është 7.2 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.
- Për çështje të kategorisë “Familjare me palë kundërshtare”, koha mesatare e arsytimit është 7.4 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.
- Për çështje të kategorisë “Familjare pa palë kundërshtare”, koha mesatare e arsytimit është 4.4 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.
- Për çështje të kategorisë “Marrëdhënie pune”, koha mesatare e arsytimit është 6 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.

- Për çështje të kategorisë “Krime”, koha mesatare e arsyetimit është 14 ditë, pra dukshëm më e shkurtër se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382/2 pg. i K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë “Kundravajtje penale”, koha mesatare e arsyetimit është 3.7 ditë, pra dukshëm më e shkurtër se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382/2 pg. i K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë “Kërkesa penale të hetimit paraprak”, për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit me objekt vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi, vleftësim ndalimi, si dhe zëvendësim/revokim mase sigurimi, koha mesatare e arsyetimit është 2.2 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 5 ditë i parashikuar nga neni 249 dhe 260 i K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë “Kërkesa penale të hetimit paraprak”, për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit me objekt verifikim kushtesh dhe kriteresh të caktimit të masës së sigurimit dhe shuarje mase sigurimi, koha mesatare e arsyetimit është 1.6 ditë, pra më e shkurtër sa afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 248/2 i K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë “Kërkesa penale të hetimit paraprak”, për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit (*caktim mase sigurimi, lejim përgjimi*), koha mesatare e arsyetimit është 0 ditë, pra më e shkurtër se afati i të posaçëm 24 orë i parashikuar nga nenet 244/1, 222/1 dhe 4 dhe 202/a pika 3 të K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë “Kërkesa penale të hetimit paraprak”, për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 6 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382/2 i K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë “Seancë paraprake – dërgim në gjyq”, për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 4.4 ditë, pra më e shkurtër afati procedural i posaçëm 10 ditë i parashikuar nga neni 332/dh pg 2 i K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë “Seancë paraprake – kërkesë për pushim procedimi” për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 9 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 382/2 i K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë “Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit” për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 5.9 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural i i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 382/2 i K.Pr.Penale.
- Për çështjet të kategorisë “Administrative me palë kundërshtarë”, rezulton koha mesatare e arsyetimit është 3.4 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural i posaçëm prej 7 ditësh i parashikuar nga neni 42/3, i ligjit 49/2012.
- Për çështjet të kategorisë “Administrative pa palë kundërshtarë”, rezulton koha mesatare e arsyetimit është 2.2 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural i posaçëm

prej 7 ditësh i parashikuar nga neni 42/3, i ligjit 49/2012.

- Për çështjet e tjera të kategorisë “Marëdhënie pune”, rezulton koha mesatare e arsyetimit është 5.2 ditë, *pra më e shkurtër* se afati procedural i posaçëm prej 7 ditësh i parashikuar nga neni 42/3, i ligjit 49/2012.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit, gjyqtari dhe kryetarët e gjykatave e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke argumentuar se bazuar në të dhënat statistikore, si edhe regjistrin e dorëzimit të vendimeve të arsyetuara në sekretari, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit është më i shkurtër ose e barabartë me afatin procedural.

Sa më sipër, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar, është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural, për të gjitha kategoritë e çështjeve.

KONKLUZIONE:

Për sa më sipër, koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor për të gjitha kategoritë e çështjeve rezulton më shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, duke treguar shkallë të lartë të aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi kjo kohë është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive.

Referuar tabelave me të dhëna statistikore dhe të dhënave që pasqyrohen në Raportin Analitik, rezulton se ka mungesë të të dhënave për numrin e seancave gjyqësore për të gjitha çështjet pasi këto të dhëna nuk gjenerohen në mënyrë elektronike. Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, treguesi i numrit të seancave për çështje bëhet pjesë e vlerësimit etik dhe profesional kur statistikatat mundësohen në rrugë elektronike. Nëse kjo nuk është e mundur, ky tregues për vlerësimin dhe zvarritjen e gjykimeve, identifikohet dhe vlerësohet vetëm për çështjet e zgjedhura me short.

Referuar sa më sipër, për vlerësimin e këtij treguesi, në mungesë të të dhënave për numrin e seancave për të gjitha çështjet, të dhënat e analizuara i referohen 6 (gjashtë) dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, të cilat janë çështje me palë kundërshtare.³²

- **Konkretisht në total** në 6 (gjashtë) çështjet e përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar është **2.2 seanca gjyqësore** (duke përfshirur seancat përgatitore dhe çështjet pa palë kundërshtare³³).

Në lidhje me numrin e seancave gjyqësore **për çdo kategori çështjesh**, rezultojnë të dhënat si më poshtë vijon:

- 2.5 seanca gjyqësore për çështje të kategorisë “Civile me palë kundërshtare”.
- 2 seanca gjyqësore për çështje të kategorisë “Familjare me palë kundërshtare”.
- 3 seanca gjyqësore për çështje të kategorisë “Seancë paraprake”.
- 1 seancë gjyqësore për çështje të kategorisë “Administrative më palë”.

Gjyqtari në vetëvlerësimin e tij, nuk ka dhënë shpjegime konkrete në lidhje me këtë tregues, por e ka vlerësuar aftësinë e tij në shkallë të lartë.

Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave gjyqësore jo produktive, duke iu referuar Raportit Analitik dhe akteve të dosjeve të përzgjedhura me short, rezulton se Gjyqtari subjekt vlerësimi ka mbikëqyrur dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët.

Konstatohet se nga ana e gjyqtarit merren të gjitha masat me qëllim shmangien e seancave joproductive çka e tregon edhe numri mesatar i seancave në masën 2.2 seanca.

KONKLUZIONI

Referuar sa më sipër, për treguesin “Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 6 çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është **2,2 seanca** dhe gjyqtari në të gjitha çështjet (me palë kundërshtare) ka marrë masat e nevojshme për shmangien

³²Sipas Metodologjisë së Pikëzimit “Për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh (civile, administrative, penale, dhe sipas shkallëve të gjykimit), **duke përfshirur ato pa palë ndërgjyqëse**”.

³³ Sipas metodologjisë së pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, në lidhje me këtë treguesin e numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, është parashikuar: ” Për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh, **duke përfshirur ato pa palë ndërgjyqëse**. ”

e seancave gjyqësore joproductive, planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të tyre.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi numri mesatar i seancave gjyqësore rezulton të jetë 2.2 seanca dhe gjyqtari ka kryer veprimet e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive.*

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se gjyqtari ka vënë në lëvizje çështjet duke zhvilluar veprimet përgatitore në dhomë këshillimi brenda një kohë shumë të shkurtër nga caktimi i tyre me short, dhe brenda afatit ligjor 7 ditor³⁴ nga data e shortit, në përputhje me parashikimet e nenit 25 pika 1 të ligjit nr.49/2012 apo brenda afatit 5 ditor parashikuar në nenin 332/1 të K.Pr.Penale në çështjen me objekt “dërgimin e çështjes në gjyq”.

- Në çështjet administrative: Në veprimet përgatitore të zhvilluara pas caktimit të çështjeve me short, gjyqtari kryen me korrektësi dhe në mënyrë të plotë veprimet procedurale të parashikuara në nenin 25 pika 1 të Ligjit nr.49/2012, duke disponuar për njoftimin e padisë dhe akteve palës së paditur dhe kur është rasti edhe të Avokaturës së Shtetit, bashkë me njoftimin për paraqitjen e tyre brenda afatit ligjor 10 ditor, duke shoqëruar disponimin e gjykatës dhe njoftimin e palës me paralajmërimin për mospranimin e tyre në rast të mosparaqitjes në afat, në respektim të parashikimeve të nenit 25 pika 1, shkronja “b” të Ligjit nr. 49/2012. Pas kalimit të afatit për paraqitjen nga pala e paditur të prapësimeve me shkrim dhe provave, gjyqtari ka zhvilluar veprimet përgatitore duke evidentuar në procesverbal veprimet e kryera për verifikimin e njoftimeve drejtuar palës së paditur, datën e komunikimit të tyre, paraqitjen ose jo të prapësimeve me shkrim nga pala e paditur brenda afatit të caktuar nga gjykata, liston provat shkresore të paraqitura nga pala si dhe disponon për caktimin e seancës përgatitore ose gjyqësore, kur vlerëson se padia i përmbush të gjitha elementët ligjorë dhe nuk ka nevojë për kryerjen e veprimeve të tjera përgatitore.

³⁴ Në çështjen gjyqësore që i përket vendimit nr.302 (447), datë 09.05.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër me objekt “konstatimin e pavlefshmërisë së aktit administrativ”, konstatohet se çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër në datë 17.01.2022 dhe i është nënshtruar shortit elektronik në datë 18.01.2022. Në dosje, rezulton i administruar vendimi “Për njoftimin e kërkesëpadisë dhe akteve shkresore” i datës 07.03.2022 (jashtë afatit 7 ditor për zhvillimin e veprimeve paraprake sipas parashikimeve të nenit 25 të Ligjit nr.49/2012), në të cilin pasqyrohen veprimet përgatitore të gjyqtarit, të zhvilluara pa praninë e palëve.

- Në çështjet civile: gjyqtari është shprehur me vendim, si për njoftimin e akteve dhe kërkesës padisë palëve të paditura konform nenit 158 të K.Pr.Civile në funksion të lëshimit të deklaratës së mbrojtjes, ashtu edhe për kalimin e çështjes në seancë përgatitore ose pajtimi në çështjet familjare (*neni 158/b i K.Pr.Civile dhe neni 132 i K. Familjes*) e në vijim, pas ezaurimit të seancës përgatitore edhe për nxjerrjen e urdhrin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore (*neni 158/ç i K.Pr.Civile*).
- Në çështjen penale me objekt “dërgimin e çështjes në gjyq” gjyqtari ka vënë çështjen në lëvizje brenda ditës ose brenda 5 ditëve, sikundër parashikohet në nenin 332/1 të K.Pr.Penale për çështjet e kategorisë seancë paraprake me objekt dërgimin e çështjes në gjyq.
- Në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtari ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore, duke caktuar seancën, si dhe ka treguar kujdes për marrjen e masave për njoftimin e palëve, me qëllim zhvillimin e seancave gjyqësore efektive. Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt, sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligj për gjykimin në shkallë të parë, si në çështjet civile, seancë paraprake apo administrative.
- Drejtimi i seancave është zhvilluar në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme në rastin e kërkesave të palëve (*si p.sh për ndarjen e kërtimeve, rrëzimin e kërkit për deklarimin e moskompetencës tokësore etj*), të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe, kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes. Të gjitha seancat kanë filluar në orar ose me vonesa të papërfillshme si dhe janë mbajtur në sistem audio.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit me efikasitet dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse. Kohëzgjatja e gjykimeve në tërësi tej afateve standarde orientuese nuk duket të jetë ndikuar nga administrimi joeficient i procesit gjyqësor, por nga lënia përgjithësisht e seancave në distanca kohore të gjata, çka ka ndikuar në pikësimin e treguesit “Plotësimi i standardeve minimale kohore” dhe “Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 6 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes rezultojnë se dosjet janë renditura në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori, në disa raste ndërthurur dhe me veprimet procedurale të gjyqtarit.

Mënyra e renditjes së akteve në dosje e bën atë lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë.

KONKLUSIONE:

Në tërësi dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara, të renditura në mënyrë logjike dhe orientojnë drejt lexuesin për vendndodhje e tyre duke krijuar mundësi për tu shfrytëzuar me lehtësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik rezultojnë se në dosje ndodhen të gjitha aktet dhe dokumentacioni i administruar gjatë gjykimit. Në çdo dosje administrohen aktet shkresore të hartuara nga gjykata (njoftimet, shkresat, procesverbalet, vendimi gjyqësor), si dhe aktet e paraqitura nga palët (kërkesa objekt gjykimi, provat e administruara, kërkesat me shkrim të palëve, diskutimet përfundimtare të tyre).

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLUSIONE:

Në tërësi, dokumentacioni i dosjeve të vëzhguara është i saktë dhe i plotë, nuk konstatohen mungesa aktesh dhe nuk konstatohet në dosje dokumentacion i cili nuk i përket çështjeve konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
92	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se për gjyqtarin {...}, gjatë periudhës së vlerësimit nuk janë dhënë ose zbatuar masa disiplinore.

Sa i përket ankesave, për periudhën e vlerësimit viti 2022, ndaj gjyqtarit, sipas informacionit të përcjellë nga ILD me shkresën nr.1044/1 prot., datë 18.04.2023, nuk rezulton të jenë paraqitur ankesa.

Në formularin e integruar të vlerësimit gjyqtari e ka vlerësuar veten në nivelin maksimal për këtë tregues duke parashtruar se në çdo rast ka shfaqur sjellje të kujdesshme, objektive, me vetëpërmbytje dhe maturi gjatë ushtrimit të detyrës. Gjithashtu gjyqtari ka theksuar se ka vepruar dhe ka shfaqur sjellje korrekte, duke shmangur çdo sjellje që tregon dhe mund të konsiderohet si mungesë respekti apo ndjeshmërie, vëmendjeje apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive.

Kryetarët e gjykatave të Shkallës së Parë Pukë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, lidhur me këtë tregues e kanë vlerësuar gjyqtarin me nivel shumë të lartë etik duke parashtruar se gjyqtari në çdo rast ka shfaqur sjellje të kujdesshme, objektive dhe maturi gjatë ushtrimit të detyrës.

KONKLUZIONE:

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna që mund të tregojnë cenimin e etikës, angazhimin apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarit, shfaqje të sjelljeve që tregojnë mungesë respekti, vetëpërbajtje, ndjeshmërie, vëmendje, apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive, gjatë ushtrimit të detyrës. Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri të lartë në funksion dhe nuk ka shfaqur sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion dhe pikëzohet më pikët maksimale.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.

3.B Integriteti i gjyqtarit

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, rezulton se për gjyqtarin {...} nuk është regjistruar asnjë ankesë në ILD dhe ndaj tij nuk janë marrë apo zbatuar masa disiplinore.

Në raportin e ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr.1850/1 prot., datë 02.05.2023, konkludohet se deri në momentin e verifikimit nga ky institucion, deklaratat e interesave private periodike/vjetore 2017-2020 janë dorëzuar brenda afateve ligjore, gjatë kontrollit është konstatuar se deklaratat e interesave private janë plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit dhe nga kontrolli i ushtruar nuk janë verifikuan raste të konfliktit të interesave.

Gjyqtari dhe kryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar integritetin në nivel shumë të lartë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicje që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim apo çdo sjellje tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtarit.

KONKLUZIONE:

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin e gjyqtarit,

gjqitari pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjellëve të pahijshme apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e tij.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë të gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtarit

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në raportin analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të tij. Gjithashtu nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve të administruara në dosjet e gjykimit si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe vlerësimi i kryetarëve të gjykatave.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit 01 janar 2022– 31 dhjetor 2022, sipas tabelës përmbledhëse me të dhënat statistikore për sasinë, shpejtësinë, përjashtimet dhe heqjet dorë nga gjykimi për gjyqtarin {...}, për periudhën e mësipërme të vlerësimit, të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë rezulton se për gjyqtarin {...} në vitin 2022 ka pasur 2 kërkesa për përjashtimin e tij, të cilat janë pranuar

të dyja. Nga të dhënat statistikore rezulton se për vitin 2022 ka pasur 1 kërkesë nga ana e gjyqtarit për heqjen dorë nga gjykimi, e cila është rrëzuar.

Sipas tabelës përmbledhëse me të dhënat statistikore për sasinë, shpejtësinë, përjashtimet dhe heqjet dorë nga gjykimi për gjyqtarin {...}, për periudhën e vlerësimit, të përcjellë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër rezulton se për gjyqtarin {...} në vitin 2022 ka pasur vetëm 1 kërkesë për përjashtimin e tij, e cila është rrëzuar.

Gjyqtari në vetëvlerësimin e tij ka parashtruar se referuar statistikës së përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, gjatë vitit 2022 ka pasur 2 kërkesa për përjashtimin e tij si gjyqtar nga gjykimi i çështjeve konkrete, duke cituar:

“1. Në lidhje me çështjen penale me kërkues Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë kundër të pandehurit Pjetër Mhilli; akuza: Kanosja dhe Vetëgjyqësi, parashikuar nga nenet 84 dhe 277 të Kodit Penal. Prokuroria ka kërkuar përjashtimin tim si gjyqtar për shkak se unë kam gjykuar më përpara të njëjtin procedim penal me të bashkëpandehur Fran Mëhilli, duke u shprehur me vendim përfundimtar. Unë i kam shprehur gjyqtarës Amarilda Sulaj mendimin tim me shkrim për pranimin e kërkesës. Gjyqtari Sulaj, pasi ka shqyrtuar kërkesën, me vendimin administrativ ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë. Në lidhje me këtë çështje penale, unë më përpara në kohë, me kërkesën e datës 26 Nëntor 2021 i kam kërkuar ish zv/kryetares së Gjykatës, znj. Flutura Hoxha miratimin e kërkesës time për dorëheqje, por ajo, ka vendosur refuzimin e kërkesës. Në këto rrethana, unë nuk kam patur mjet tjetër procedural, për mos të vijuar me gjykimin e kësaj çështje penale, pavarësisht se bëhej fjalë për të njëjtin procedim penal për të cilin unë kisha shpallur vendimin përfundimtar ndaj të bashkëpandehurit Fran Mëhilli .

2. Në lidhje me kërkesën për përjashtim të Prokurorisë nr. 2634 prot., datë 27.12.2022 që i përket çështjes penale me viktimë akuzuese Vitor Voci; të akuzuar: Zef Lika, {...} Lika; palë e interesuar: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; akuza: Dëmtime të tjera me dashje në bashkëpunim, parashikuar nga neni 90 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal. Më përpara në kohë, i kam paraqitur zv/Kryetarit të Gjykatës kërkesën për miratimin e heqjes dorë nga kjo çështje penale, por një kërkesë e tillë është refuzuar. Në lidhje me kërkesën e Prokurorit, zv/kryetarja e Gjykatës Pukë me vendimin administrativ nr. 26 Regj., datë 29.12.2022 ka vendosur deklarimin e papranueshëm të kërkesës.

Duke e përmbledhur, gjatë vitit 2022 ka patur 2 kërkesa për përjashtimin tim si gjyqtar. Për njëjtin prej kërkesave është vendosur pranimi i saj, kurse për kërkesën e dytë është vendosur deklarimi si i papranueshëm. Pasja vetëm e 2 kërkesave për përjashtim mendoj se është i pakonsiderueshëm.”

Kryetarët e gjykatave në të cilat gjyqtari ka ushtruar detyrën në periudhën e vlerësimit lidhur me këtë tregues, kanë deklaruar se numri i kërkesave për përjashtimin e gjyqtarit është i pakonsiderueshëm.

KONKLUZIONE:

Sa më sipër, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është “*I pakonsiderueshëm*”, duke qenë se gjatë kësaj periudhe vlerësimi, dy kërkesat e pranuar për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi janë për shkak të pjesëmarrjes në procedim, për të cilat ai ka kërkuar më herët heqjen dorë, kërkesë e refuzuar nga Kryetari i Gjykatës.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për në treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet si “I pa konsiderueshëm”.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se gjyqtari gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces komunikon në mënyrë të qartë, transparente, e kuptueshëm duke respektuar të drejtat e palëve dhe duke treguar kujdes për të treguar trajtim të barabartë dhe me dinjitet të tyre. Gjithashtu, rezulton komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe për pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë.

Në komunikimin shkresor me subjektet palë ose jo në procesin gjyqësor, gjuha e përdorur është korrekte, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

Të njëjtat cilësi evidentohen edhe në vetëvlerësimin e gjyqtarit dhe vlerësimin e kryetarëve të gjykatave, në të cilat ka ushtruar funksionin gjyqtari subjekt vlerësimi lidhur me këtë tregues.

KONKLUSIONE:

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes për të qenë i qartë, i drejtpërdrejtë dhe i kuptueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale për të cilat gjyqtari vihet në dijeni për shkak të funksionit. Në çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton të ketë pasur të dhëna me karakter sensitiv apo personal. Gjithashtu, nga burimet e tjera të vlerësimit nuk ka asnjë të dhënë apo indicje për cenim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale të palëve apo pjesëmarrësve në gjykim.

KONKLUSIONE:

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “E lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar.

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezultojnë asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit.

Gjyqtari ka deklaruar dhe kryetarët e gjykatave e kanë vlerësuar maksimalisht këtë tregues duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët është në nivel maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale, përfshirjen në diskutime ligjore, organizimin e punës në gjykatë dhe komunikimin brenda trupave gjyqësore.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezultojnë se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore ndërkohë që gjyqtari dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë duke parashtruar se gjyqtari ka komunikim dhe ndërveprim shumë të lartë me stafin e gjykatës, dhe ka krijuar një marrëdhënie harmonike dhe bashkëpunuese me ta.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezultojnë se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se gjyqtari {...}, gjatë periudhës së vlerësimit viti 2022, ka marrë pjesë në 6 aktivitete trajnuese, të cilat janë pjesë e Programit të Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në tërësi aktivitete trajnuese në të cilat ajo ka marrë pjesë janë shtrirë në një periudhë kohore prej 6.5 ditësh.

Sipas parashikimeve të nenit 5 pika 3 të Ligjit për Statusin *periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve; b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve.* Në rastin konkret, gjyqtari ka marrë pjesë në 6 aktivitete trajnuese të shtrira në 6.5 ditë trajnimi, brenda kufijve minimale dhe maksimalë (5 deri në 40 ditë në vit) të përcaktuara nga Ligji për Statusin, duke përmbushur detyrimin ligjor për pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese të përshtatshme për funksionin e tij dhe që i përkasin fushës së veprimtarisë së tij pasi rezultojnë te jenë aktivitete me tema të së drejtës procedurale dhe materiale penale si dhe në fushën e të drejtave të njeriut.

Në Formularin e Integruar të Vetëvlerësimit gjyqtari ka deklaruar se gjatë periudhës së vlerësimit është angazhuar maksimalisht në programin e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës me qëllim ngritjen profesionale, duke u përfshirë në diskutime, shkëmbim të përvojave profesionale.

KONKLUZIONE:

Nga analiza e të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në 6 aktivitete trajnuese të shtrira në 6.5 ditë trajnimi, brenda kufijve minimale dhe maksimalë (5 deri në 40 ditë në vit) të përcaktuara nga Ligji për Statusin.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Sh.M dhe trajnime është nga 5-40 ditë në vit (për periudhën e vlerësimit viti 2022) duke u pikëzuar me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk evidentohet angazhimi i gjyqtarit {...} në cilësinë e ekspertit ose lehtësuesit në aktivitete trajnuese. Gjyqtari ka deklaruar se nuk ka qenë në listat e gjyqtarëve udhëheqës në praktikën profesionale të kandidatëve për gjyqtarë, por ka aplikuar pranë Shkollës së Magjistraturës për lehtësues duke dërguar edhe dokumentacionin e përcaktuar nga shkolla dhe se nuk është përfshirë në listën e lehtësuesve nga ana e Shkollës.

Nuk rezultojnë të dhëna të tjera për përfshirjen e tij në aktivitete trajnuese të organizuara nga institucione të tjera.

Lidhur me disponueshmërinë e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional, nuk rezultojnë të dhëna.

Lidhur me këtë tregues gjyqtari ka parashtruar *se sikurse jam shprehur edhe në formularët e vetëvlerësimeve, unë nuk kam patur ftesë. Para pak javësh, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, me anë të emailit, jam ftuar për të shprehur vullnetin për të qenë pjesë e gjyqtarëve udhëheqës. Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 326, date 06.07.2023, ka vendosur të përditësojë trupën e gjyqtarëve udhëheqës. Referuar listës bashkëlidhur vendimit, jam i përfshirë në listën e përditësuar të gjyqtarëve udhëheqës për periudhën 2021-2024*

KONKLUZIONE:

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, *pavarësisht nga frekuenca e angazhimit*, për gjyqtarin {...}, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për përfshirjen e tij në cilësinë e ekspertit/lehtësuesit në aktivitete të trajnimit vazhdues pranë SHM apo aktivitete të organizuara nga institucione/organizata të tjera, ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtari pikëzohet me 3 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezultojnë të dhëna konkrete për pjesëmarrjen e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Gjyqtari lidhur më këtë tregues në Formularin e Integruar të Vetëvlerësimit ka sqaruar se gjatë ushtrimit të detyrës është angazhuar maksimalisht në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Kryetarët e gjykatave në të cilat gjatë periudhës së vlerësimit ka ushtruar detyrën gjyqtari kanë deklaruar se gjyqtari gjatë ushtrimit të detyrës është angazhuar maksimalisht në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata. Sa më sipër nuk rezulton të jenë evidentuar angazhimet konkrete në të cilat gjyqtari mund të jetë marrë pjesë gjatë periudhës së vlerësimit.

KONKLUZIONE:

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit konkret në këto veprimtari, për gjyqtarin {...}, duke qenë se rezultojnë nuk rezultojnë të dhëna konkrete, ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtari pikëzohet me 3 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarit në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezultojnë të dhëna.

Evidentohet se gjyqtari në Formularin e Integruar të Vetëvlerësimit ka deklaruar se *nuk ka publikime ligjore akademike për vitin 2022.*

KONKLUZIONE:

Për sa më sipër, në mungesë të të dhënave për këtë tregues, gjyqtari pikëzohet me zero pikë.

***Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezulton angazhim i gjyqtarit dhe për këtë shkak pikëzohet me 0 pikë.*

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
91	Shkëlqyeshëm

**NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE
NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT**

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	87	Shumë mirë
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	92	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	370	Shumë mirë

PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93 pika 5 shkronja “ç” të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtari {...} të mbajë në konsideratë angazhimin e tij të vazhdueshëm në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit të tij për përmirësimin e sistemit gjyqësor. Gjyqtari duhet t’i kushtojë më shumë kujdes respektimit të standardeve minimale kohore, përzgjedhjes së kujdesshme të gjuhës në arsyetimin e vendimeve, saktësisë së dispozitivit të vendimit me qëllim që ai të jetë i qartë dhe i zbatueshëm, si dhe përditësimin me praktikën e konsoliduar të Gjykatës së Lartë.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1
KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTARIN {...}
PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2022- 31 DHJETOR 2022

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT				Pikët total	Niveli i vlerësimit	
				87	Shumë mirë	
Treguesit	Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë		
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Mbi mesataren	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të	Mbi mesataren	12	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë	

		përzgjedhura për vlerësim			Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Mbi mesataren	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				92	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	11-20%	12	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë

	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	31-40%	2	Jashtë afatit: Mbi 40 %- 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve	3	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	+99%	10	Tej standardit : Nën 81 %- 2 pikë Mbi 81-87 % - 4 pikë Mbi 87- 93 % - 6 pikë Mbi 93-99 % - 8 pikë +99% - 10 pikë

	<p>d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor</p>	<p>1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit</p>	<p>Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve</p>	<p>15</p>	<p>Koha mesatare: Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë</p>
<p>B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore</p>	<p>a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive</p>	<p>1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit</p>	<p>1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë</p>	<p>15</p>	<p>Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarit: Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë</p>

					1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues	Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia	

A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e gjyqtarit: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
B. Integriteti i gjyqtarit	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të gjyqtarit : E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
C. Paanësia e gjyqtarit	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë

	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				91	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparencja e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të	a. Shkalla e komunikimit dhe	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit:

bashkëpunuar	bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave			E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë	
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë	
C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtari	5-40 ditë (Periudha 1/vjeçare)	20	Pjesëmarrja e gjyqtarit: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4	
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Nuk ka të dhëna		3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtarit	Nuk ka të dhëna		3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë

	gjkata	4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarit			
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të tij	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
KËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			370		
VELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT			Shumë mirë		

